

RAPORTI VJETOR

# 2024





**KCS**

КОМИСИЈА ЗА  
ЗАШТИТА ОД ДИ

Raport vjetor për punën e  
Komisionit për Parandalim dhe  
Mbrojtje nga Diskriminimi  
për vitin 2024



Shkup, mars viti 2025

## Përmbajtja

Rezyme .....	7
Sistemimi, kompetencat ligjore dhe përbërja e Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi.....	10
Korniza ligjore .....	10
Anëtarët e KPMD-së .....	11
Shërbimi profesional.....	12
Statusi i kompetencave të zbatuara të Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi .....	15
Parashtresa për mbrojtje nga diskriminimi .....	15
Të dhënat demografike për paraqitësit e parashtresave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Harta gjeografike e paraqitësve të parashtresave .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Bazat e paraqitura dhe fushat e diskriminimit në lëndët e reja për vitin 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Bazat e paraqitura të diskriminimit .....	24
Fushat e paraqitura të diskriminimit .....	27
Procedura për mbrojtje nga diskriminimi të nisura me detyrë zyrtare	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Vendimmarrja e Komisionit në lëndë për mbrojtje nga diskriminimi	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Diskriminim i vërtetuar në vitin 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Llojet e diskriminimit në rastet e vërtetuara në vitin 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Bazat e diskriminimit në rastet e vërtetuara në vitin 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Fushat e diskriminimit në rastet e vërtetuara në vitin 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Statusi i përmbushjes së rekomandimeve të Komisionit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Përfshirja e KPMD-së në procedurë gjyqësore si lehtësues dhe si mik i gjykatës “amicus curiae”.....	42
Aktivitetet parandaluese dhe aktivitetet e tjera të KPMD-së .....	44
Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare të vitit 2024 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Aktivitetet parandaluese me Agjencinë Gjermane të Bashkëpunimit Ndërkombëtar - GIZ Maqedonia e Veriut .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Aktivitetet parandaluese me Misionin e OSBE-së Shkup .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Aktivitetet parandaluese me ADI- Gostivar dhe HOPS Shkup .....	46

Aktivitetet parandaluese me Institutin e të drejtave themelore të njeriut "Ludvig Bolcman" Austri .....	46
Aktivitete parandaluese me nismë personale .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Memorandume bashkëpunimi me institucione dhe organizata .....	47
Raportim dhe përfaqësim ndërkombëtar .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Mendime dhe rekomandime për ligjet .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Prezenca e Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi në media .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Buxheti dhe puna financiare .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 1: Raste nga praktika.....	58
Shtojca 2: Llogaria përmbyllëse .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>



## Përmbledhje

Ky raport paraqet arritjet dhe aktivitetet e realizuara të Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi (në tekstin e mëtejshëm: KPMD ose Komisioni) në vitin 2024.

KPMD është institucion nacional për të drejtat e njeriut, kompetent për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi. Është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kompetencat i kryen në pajtim me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi.

Gjatë vitit 2024, Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi (KPMD) ka punuar gjithsej 485 raste për mbrojtje nga diskriminimi, prej të cilëve 407 raste të reja të hapura në vitin 2024, ndërsa 78 raste të bartura nga viti paraprak. Nga 407 rastet e reja, 405 janë ankesa të paraqitura nga qytetarët dhe organizatat, ndërsa dy rastet tjera janë procedura që KPMD i ka nisur me detyrë zyrtare.

Numri më i madh i parashtresave ka të bëjë me diskriminimin mbi bazën e përkatësisë kombëtare ose etnike (27%), më pas vijojnë baza tjetër, bindja tjetër, veçoria personale dhe statusi shoqëror, bindje politike, arsimit dhe gjinia, ndërsa në numër më të vogël edhe bazat e tjera të diskriminimit. Femrat kanë paraqitur më shpesh diskriminim mbi bazë të gjinisë, arsimit, moshës dhe statusit familjar ose martesor, ndërsa meshkujt kanë paraqitur më shpesh ankesa për diskriminim mbi bazat e ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, orientimit seksual, përkatësisë në grup të marginalizuar, shtetësisë dhe aftësisë së kufizuar.

Lidhur me fushat, më shumë parashtresa janë bërë për mbrojtje nga diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës (39), ndërsa kemi pranuar parashtresa edhe në fushat e anëtarësisë dhe veprimtimit në organizata sindikale dhe organizata të tjera, më pas informim publik dhe media, arsim, shkencë dhe sport etj., qasja në të mira dhe shërbime, gjyqësor dhe administratë dhe në fusha të tjera.

Komisioni në vitin 2024 ka mbajtur 24 seanca ku janë marrë 316 vendime për lëndë për mbrojtje nga diskriminimi, prej të cilave 48% janë mendime të procedurës së realizuar për vërtetimin e diskriminimit, ndërsa 52% janë konkluzione për refuzimin e parashtresës përkatësisht për mosveprim apo për ndërprerje të procedurës. Shumica e parashtresave për të cilat nuk ka qenë e mundur të iniciohet procedurë, janë refuzuar për shkak të parregullsisë së parashtresës ose për shkak se KPMD nuk ka pasur kompetencë ligjore për të vepruar. Edhe pse nuk është realizuar procedura për vërtetimin e diskriminimit, Komisioni në të gjitha këto raste, parashtresave u ka dhënë informacione dhe udhëzime për mënyrën dhe organin publik tek i cili duhet të drejtohen për realizimin e të drejtave të tyre. Nga lëndët për të cilat KPMD ka marrë mendim për vërtetimin e diskriminimit, në 56 raste apo 37% është vërtetuar diskriminimi, ndërsa në 96 raste apo 63% nuk është vërtetuar diskriminimi.

Baza më e zakonshme e evidentuar për diskriminim në mendimet e Komisionit në vitin 2024 është prejardhja kombëtare ose etnike, e ndjekur nga arsyet e statusit personal dhe të statusit

social, të anëtarësimit dhe të aktivitetit në organizatë sindikale, të gjinisë, të identitetit gjinor, të orientimit seksual, të bindjeve politike, të aftësisë së kufizuar dhe të arsyeve të tjera. Ashtu si një vit më parë, diskriminimi më i shpeshtë është në institucionet e sektorit publik (37 raste ose 66%), ndërsa raste janë evidentuar edhe në sektorin privat (9 raste ose 16%) si dhe në rrjetet sociale dhe media (10 raste ose 18%). Sa u përket fushave, rastet më të evidentuara janë në punë dhe marrëdhëniet e punës, arsim, shkencë dhe sport, informim publik dhe media, gjyqësor dhe administratë, qasja në shërbime dhe fusha të tjera.

Një pjesë e rasteve të cilat kanë ndikim më të madh apo kanë të bëjnë me problem sistemor që shkakton diskriminim apo mund të vendoset në pozitë diskriminuese një grup më i madh i njerëzve, KPMD në mënyrë plotësuese i prezanton në paraqitjet publike, më pas në raporte të posaçme tematike, njoftime dhe deklarata. Këto ofrojnë qasje në gjendjet e krijuara, zbulimin e praktikave negative publike dhe të trendeve, por shërbejnë edhe për edukimin e qytetarëve si dhe detektimin e situatave të ngjashme në të cilat janë gjetur, me qëllim që të nxiten t'i paraqesin në Komision.

KPMD ndjek realizimin e mendimeve dhe rekomandimeve për rastet konkrete të diskriminimit deri në plotësimin e tyre e në rast se ato nuk plotësohen, ka obligim ligjor të dërgojë kërkesë për nisjen e procedurës kundërvajtëse pranë gjykatës përkatëse. Për shkak të mosveprimit sipas rekomandimeve të Komisionit, në vitin 2024 janë dorëzuar 10 kërkesa për procedurë kundërvajtëse ndaj diskriminuesve të vërtetuar, ndërsa deri në fund të vitit, janë miratuar dy aktgjykime nga gjykata përkatëse e shkeljeve.

Në periudhën raportuese, KPMD ka vepruar si mik i gjykatës (*amicus curiae*) në dy procedura gjyqësore në bazë të padive të dorëzuara për diskriminim të kryer. E para është për padi me interes publik (*actio popularis*) para Gjykatës Themelore Civile - Shkup, kundër Ministrisë së Drejtësisë - Drejtorisë së Udhëheqjes së Librave të Amzës, nga ana e paditësve - Qendra Europiane e të Drejtave të Romëve (QEDR) dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (ShMJR) - Shkup, për vërtetimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë të vazhduar dhe të përsëritur në bazë të përkatësisë së grupit të marginalizuar, përkatësisë etnike, veçorisë personale dhe statusit shoqëror ndaj të gjithë personave të evidentuar në librin e veçantë të amzës të personave të lindur që kanë marrë dokument identifikimi ndërsa kanë pasur diskriminim indirekt të vazhduar dhe të përsëritur në bazë të përkatësisë etnike, ndaj të gjithë romëve, të evidentuar në librin e veçantë të amzës të personave të lindur që kanë marrë dokument identifikimi. Në rastin e dytë, KPMD ka vepruar si mik i gjykatës në bazë të padisë së dorëzuar për mbrojtjen nga diskriminimi pranë Gjykatës Themelore- Manastir ndaj personit nga Manastiri për kryerjen e diskriminimit të vazhduar dhe të përsëritur dhe shqetësimit ndaj personat LGBT në rrjetet sociale.

Komisioni si organ qendror nacional për barazi jep mendim profesional për propozimligjet për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe kontribuon në ndryshimet dhe plotësimet e kornizës ligjore, për harmonizimin e tij me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi ku ligjet do të përfshijnë dispozita për parandalimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e diskriminimit. Në vitin 2024, KPMD ka dhënë mendime me udhëzime konkrete për propozimligjet për arsim të mesëm dhe fillor pranë MASH-it në fazën e përgatitjes së tyre, por asnjë nga

vërejtjet kyç nuk është inkorporuar në propozimtekstet finale me fillimin e procedurës ligjvënëse. KPMD ka paralajmëruar se ashtu siç janë propozuar, dispozitat janë të pamjaftueshme për parandalimin e veçimit të fëmijëve romë ndërsa gjithashtu e cenojnë përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta, barazinë gjinore dhe mbrojtjen e të rinjve me orientim të ndryshëm seksual dhe identitetet gjinor nga dhuna dhe diskriminimi.

Vitin e shënuan edhe zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale. Në prag të zgjedhjeve, Komisioni kujtoi dhe paralajmëroi se ende nuk janë përmbushur rekomandimet që u dhanë në vitin 2021, për eliminimin e diskriminimit që e nënvizon Kodi zgjedhor në bazë të moshës, gjendjes shëndetësore dhe statusit personale, me çka drejtpërdrejt para mbajtjes së ciklit të ri zgjedhor, grupe të ndryshme të qytetarëve sërish pamundësohen ta realizojnë të drejtën e tyre të votës. KPMD gjithashtu ka realizuar aktivitete parandaluese për ngritjen e vetëdijes për proces korrekt zgjedhor pa diskriminim dhe gjuhë të urrejtjes.

Gjatë vitit, KPMD ka realizuar aktivitete tjera parandaluese me organizata partnerë nga vendi dhe jashtë ndërsa gjithashtu ka vazhduar dhe thelluar bashkëpunimin në sektorin civil dhe institucionet shtetërore nëpërmjet lidhjes së memorandumeve të bashkëpunimit.

Raporti vjetor jep pasqyrë të qartë dhe të strukturuar të zbatimit të kompetencave të KPMD-së i cili gjithashtu përmban të dhëna statistikore për vitin 2024. Janë treguar edhe Statusi, kryesia, kompetencat dhe struktura organizative e Komisionit, aktivitetet e realizuara, bashkëpunimi i realizuar me institucione tjera dhe organizata nga vendi dhe jashtë, prezenca e mediave si dhe puna buxhetore dhe financiare e KPMD-së.

Raporti përmban dy shtojca, përkatësisht:

Shtojca 1: Raste të veçuara nga praktika

Shtojca 2: Llogaria përmyllëse për vitin 2024

# Sistemimi, kompetencat ligjore dhe përbërja e Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi

## Korniza ligjore

Komisioni i Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi është themeluar me Ligjin e Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 258/2020 më 24 tetor 2020), si organ i pavarur dhe ka cilësinë e personit juridik. Kompetencat e Komisionit mund të ndahen në këto funksione kryesore: parandalues, promovues, mbrojtës, këshillëdhënës dhe profesional dhe të njëjtat në mënyrë taksative përmenden në nenin 21 të Ligjit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi.

- Merr aktivitete për promovimin, mbrojtjen dhe parandalimin e barazisë, të drejtat e njeriut dhe mosdiskriminimin.
- Ndjek zbatimin e Ligjit dhe jep mendimet dhe rekomandimet;
- Promovon parimin e barazisë, të drejtës për mosdiskriminim dhe menaxhimin me të gjitha format e diskriminimit nëpërmjet rritjes së vetëdijes publike, informimit dhe edukimit;
- Kontribuon në përgatitjen dhe zbatimin e programeve dhe materialeve nga fusha e arsimit formal dhe joformal;
- Përgatit dhe publikon raporte të veçanta tematike për çështje të caktuara nga fusha e barazisë dhe mosdiskriminimit;
- Jep rekomandime të përgjithshme për çështje të caktuara nga fusha e barazisë dhe mosdiskriminimit dhe e ndjek zbatimin e tyre;
- Angazhohet për ratifikimin e marrëveshjeve dypalëshe apo shumëpalëshe ndërkombëtare nga fusha e të drejtave të njeriut dhe e ndjek zbatimin e tyre;
- Kontribuon gjatë përgatitjes së raporteve që shteti obligohet t'i dorëzojë tek organet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut dhe kontribuon për realizimin e rekomandimeve të tyre;
- Promovon dhe propozon harmonizimin e legjislacionit nacional, dispozitave dhe praktikave me instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut;
- Nis ndryshime të dispozitave për shkak të zbatimit dhe zhvillimit të mbrojtjes nga diskriminimi;
- Jep mendim për propozimligjet me rëndësi për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi;
- Vendos bashkëpunim me personat fizikë dhe juridikë si dhe me shoqatat, fondacionet partnerët socialë për realizimin e parimit të barazisë dhe zhvillimit të parandalimit dhe të mbrojtjes nga diskriminimi;
- Bashkëpunon me organe përkatëse nacionale dhe shtete të tjera dhe me organizata ndërkombëtare dhe rajonale në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi;
- Vepron ndaj parashtresave, jep mendime, rekomandime dhe konkluzione për raste konkrete të diskriminimit;

- Nis procedurë për mbrojtje nga diskriminimi me detyrë zyrtare;
- I jep informacione personit të interesuar për të drejtat e tij dhe mundësitë për nisjen e procedurës gjyqësore apo procedurë tjetër;
- Ndjek realizimin e mendimeve dhe rekomandimeve për rastet konkrete të diskriminimit deri në përmbushjen e rekomandimeve që i jep KPMD;
- Paraqitet si ndërhyrës në procedura gjyqësore;
- Mund të veprojë si mik i gjykatës (amicus curiae);
- Për punën e tij, KPMD çdo tre muaj e informon opinionin për rastet e diskriminimit, i ndan mendimet dhe rekomandimet me opinionin nëpërmjet çdo lloji të mediumit;
- KPMD ka mundësi të formojë organe këshillëdhënëse me ekspertë për çështje të caktuara specifike, të grumbullojë dhe publikojë të dhëna statistikore dhe të dhëna tjera dhe të formojë bazë të të dhënave lidhur me parandalimin dhe zhvillimin e mbrojtjes nga diskriminimi;
- KPMD për punën e tij dorëzon raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe ka për obligim që të gjitha raportet, përfshirë edhe raportin financiar, t'i publikojë në ueb faqen e KPMD-së.

## Anëtarët e KPMD-së

Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi përbëhet nga shtatë anëtarë që i emëron Kuvendi i RMV-së dhe kanë status të personave të emëruar që e kryejnë funksionin në mënyrë profesionale, pa e lidhur me ndonjë funksion tjetër publik, profesion apo funksion në parti politike. Anëtarët zgjidhen në procedurë transparente nëpërmjet konkursit publik nga Kuvendi me debat të obligueshëm. Është shumë e rëndësishme të përmendet kriteri i përzgjedhjes së anëtarit të KPMD-së sipas ligjit, që kërkon të paktën shtatë vite përvojë pune në fushën e të drejtave të njeriut, prej të cilave pesë në fushën dhe barazisë dhe mosdiskriminimit, me çka garantohet profesionalizmi i anëtarëve të Komisionit dhe e ul mundësinë për ndikim dhe arbitraritet në emërimin e tyre.

Anëtarët e KPMD-së zgjidhen me mandat pesëvjeçar, me të drejtë të rizgjedhjes. Gjatë përzgjedhjes së përbërjes së parë të Komisionit, katër anëtarë zgjidhen me mandat pesëvjeçar ndërsa tre me mandat trevjeçar. Nga radhët e anëtarëve, Komisioni zgjedh kryetarin me mandat njëvjeçar, pa të drejtë për rizgjedhje.

Më 15 janar të vitit 2024, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut mori vendim për emërimin e katër anëtarëve të Komisionit përkatësisht, tre anëtarë me mandat pesëvjeçar dhe një me mandat njëvjeçar, dy muaj dhe tetë ditë përkatësisht me mandat deri në fund të mandatit të anëtarit të Komisionit të cilit në vitin 2020, me kërkesë të tij, i është ndërprerë mandati. Me emërimin e këtyre anëtarëve, Komisioni për herë të parë pas zgjedhjes së përbërjes së parë në vitin 2021, ka funksionuar me përbërje të plotë. Përbërja aktuale e KPMD-së e shpreh karakterin shumetnik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, por me shtatë anëtarë, prej të cilëve vetëm dy gra, nuk është e baraspeshuar në aspektin gjinor.


## Shërbimi profesional

Për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe teknike të Komisionit formohet shërbim profesional. Të punësuarit në shërbimin profesional kanë status të nëpunësve administrativë dhe ndaj tyre zbatohen dispozitat e Ligjit të Nëpunësve Administrativë. Me shërbimin profesional udhëheq sekretari i përgjithshëm të cilin e emëron KPMD-ja.

Në bazë të analizës funksionale, miratohet dhe zbatohet Rregullorja e organizimit të brendshëm dhe Rregullorja e sistemit të vendeve të punës së shërbimit profesional, me çka vërtetohet sistemimi organizativ si në vijim:

1. **Spektori i mbështetjes administrative - financiare**
  - 1.1. Njësia e punëve të përgjithshme dhe juridike
  - 1.2. Njësia e marrëdhënieve me publikun
  - 1.3. Njësia e çështjeve financiare
2. **Spektori i parandalimit dhe i mbrojtjes nga diskriminimi**
  - 2.1. Njësia e mbrojtjes nga diskriminimi
  - 2.2. Njësia e parandalimit nga diskriminimi dhe promovimit të parimit të barazisë
3. **Spektori i analitikes, i bashkëpunimit nacional ndërinstytucional dhe i bashkëpunimit ndërkombëtar**
  - 3.1. Njësia e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe e bashkëpunimit me institucione dhe organizata civile
  - 3.2. Njësia e kërkimeve dhe analizave

Pasqyra grafike e strukturës organizative është dhënë në Grafiku 1.



Grafiku 1

*Në Rregulloren e sistemit të vendeve të punës në Komisionin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi janë 40 vende pune të nëpunësve administrativë me gjithsej 46 realizues, prej të cilave janë të plotësuara vetëm 16 vende pune, që nënkupton përmbushje prej 35%*

Numri i të punësuarve në shërbimin profesional të Komisionit krahasuar me vitin 2023, mbetet i njëjtë përkatësisht gjatë viti 2024, në Komisionin e Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi nuk është realizuar asnjë punësim i ri. Në fakt, edhe pse Komisioni ka përqindje të vogël të përmbushjes së vendeve të sistemuara të punës dhe ka nevojë për punësime të reja të nëpunësve administrativë, Ministria e Financave nuk ka dhënë pëlqim për punësime të reja për vitin 2024 dhe të njëjtat nuk janë paraparë në Planin vjetor të punësimit për vitin 2024.

Duke i respektuar rekomandimet e Ministrisë së Financave, e cila nuk ka dhënë pëlqim për propozimplanin vjetor për punësime për vitin 2024, e që bazohen në përcaktimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për optimizimin e administratës publike, në Planin vjetor të punësimit për vitin 2024, në këtë Komision janë paraparë vetëm 2 (dy) avancime të nëpunësve administrativë me konkurs të brendshëm, por të njëjtat nuk janë realizuar.

Gjendja me dispozicionin e vogël të burimeve njerëzore dhe përqindjen e madhe të vendeve të paplotësuara të punës në Komision, e ul potencialin e shërbimit profesional për funksionim të papenguar, përmbushje të detyrave të punës dhe realizimin e kompetencave ligjore të Komisionit. Përcaktimi strategjik për përf forcimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore si dhe

krijimi i shërbimit profesional dhe të pavarur administrativ i KPMD-së mbetet sfidë edhe në vitin 2025-së.

Në Grafiku 2 është dhënë pasqyra e gjendjes me ekipimin me burimet njerëzore në Komision (anëtarët dhe shërbimi profesional) përkatësisht përqindja e pozicioneve të plotësuara të vendeve të punës në shërbimin profesional dhe përqindja e pozicioneve të plotësuara të personave të emëruar, përmbyllur me 31.12.2024.

### Plotësimi i vendeve të punës në KPMD

Në vitin 2024 KPMD-ja nuk mori miratim financiar për punësime të reja pavarësisht se dy të tretat e vendeve të punës nuk janë plotësuar




Grafiku 2

## Statusi i kompetencave të zbatuara të Komisionit të Parandalimit dhe Mbrojtjes nga Diskriminimi

Në pajtim me kompetencat e vërtetuara në Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe Rregulloren e punës, Komisioni punon vazhdimisht ndërsa merr vendime në seancat që mbahet sipas nevojës. Në vitin 2024, KPMD ka punuar gjithsej në 485 lëndë për mbrojtje nga diskriminimi, prej të cilave 407 janë të reja, të hapura në vitin 2024 ndërsa 78 lëndë janë të trashëguara nga viti 2023 (Grafiku 3). Sikur edhe në vitet e kaluara, numri më i madh i lëndëve janë parashtrës të dorëzuara nga qytetarët dhe personat fizikë (482 ose 99,38%), ndërsa pjesa tjetër janë procedura për mbrojtje nga diskriminimi që Komisioni i ka ngritur me detyrë zyrtare (3 ose 0,62%). Në vitin 2024, Komisioni ka mbajtur 24 seanca në të cilat janë marrë 316 vendime për lëndë konkrete për mbrojtje nga diskriminimi.

KPMD në vitin 2024 ka punuar gjithsej 485 lëndë për mbrojtje nga diskriminimi  
407 janë të reja ndërsa 78 të transferuara më herët



Grafiku 3

### Parashtrës për mbrojtje nga diskriminimi

Në pajtim me nenin 23 të Ligjit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, çdo person (fizik dhe juridik), mund të dorëzojë parashtrësë për mbrojtje nga diskriminimi pranë KPMD-së, pa obligim që të paguajë taksë apo ndonjë kompensim tjetër.



Personat që konsiderojnë se kanë qenë të diskriminuar, mund të dorëzojnë parashtrësë në KPMD, personalisht apo të përfaqësuar nga person tjetër (prind/kujdestar në emër të fëmijës së tij të mitur ose prind/kujdestar në emër të personit me pengesa në zhvillim) si dhe të përfaqësuar nga avokat, shoqatë, fondacion ose sindikatë me pëlqim të dhënë paraprakisht.



Shoqatat, fondacionet, sindikatat ose organizatat tjera të shoqërisë civile dhe institucionet, që kanë interes të arsyetuar për mbrojtjen e interesave të një grupi të caktuar apo në suazat e veprimtarisë së tyre merren me mbrojtjen nga diskriminimi,

mund të dorëzojnë parashtresë, nëse vërtetohet se me veprimin e një personi të caktuar fizik apo juridik, është diskriminuar numër më i madh i njerëzve.

Parashtresa e diskriminimit pranë Komisionit mund të dorëzohet në disa mënyra përkatësisht me postë, personalisht në hapësirat e KPMD-së dhe në mënyrë elektronike.



Dorëzimi i parashtresës me postë bëhet duke dërguar formular të plotësuar për denoncim të diskriminimit apo parashtresë të shkruar me dorë, me të gjitha të dhënat e nevojshme në adresën të Komisionit.




Parashtresa mund të bëhet gojarisht në procesverbal ose duke plotësuar formularin për denoncim të diskriminimit në hapësirat e Komisionit.



Dërgimi elektronik bëhet nëpërmjet shërbimit elektronik "Denonco diskriminim" në faqen e Komisionit (<https://kszd.mk/пријави-дискриминација/>) ose në adresën elektronike [contact@kszd.mk](mailto:contact@kszd.mk)

**Në vitin 2024 në KPMD janë dorëzuar 405 parashtresa për mbrojtje nga diskriminimi, që është rritje prej 43% në raport me numrin mesatar të parashtresave të reja të pranuar në periudhën 2021/23 (Grafiku 4). Në krahasim me vitin paraprak, numri është ulur për 22%, ndërsa i njëjti ka të bëjë me numër më të ulët të denoncimeve të pranuar për ngjarje të njëjta (dy dhe më shumë parashtresa të dorëzuara kundër diskriminuesit të njëjtë potencial dhe për punën e njëjtë juridike), që në vitin 2024 është 64, ndërsa në vitin 2023 madje 185, që është dallim prej 121 parashtresa.**

Në vitin 2024, janë dorëzuar 405 ankesa të reja, që përbën një rritje prej 43% nga mesatarja në periudhën 2021-2023.




Grafiku 4

Nga gjithsej 405 parashtresa të dorëzuara në vitin 2024, 351 ose 87% janë parashtresa për mbrojtje nga diskriminimi potencial të personave fizikë ndërsa 54 ose 13% janë parashtresa të dorëzuara nga persona juridikë për mbrojtje nga diskriminimi të një grupi të caktuar apo numër më të madh të personave. Nga parashtresat e dorëzuara nga persona fizikë, 273 ose 78% janë dorëzuar personalisht nga qytetarë që konsiderojnë se kanë qenë të diskriminuar (Grafiku 5). Nga pjesa tjetër, 75 janë parashtresa të qytetarëve të dorëzuara nëpërmjet personit të autorizuar (avokat, sindikatë ose shoqatë civile), ndërsa 3 janë parashtresa në emër të personit tjetër fizik, për çka nevojitet legjitimim aktiv. Vlen të theksohet se pranë KPMD-së janë dorëzuar 22 parashtresa nga prind në emër të fëmijës së tij të mitur, që është 5% nga numri i përgjithshëm i parashtresave të dorëzuara në vitin 2024.

Qytetarët që besojnë se janë diskriminuar më shpesh paraqesin një ankesë personalisht, pa ndërmjetës.


një përqindje më e vogël paraqet një ankesë përmes një avokati, sindikate ose shoqate



Grafiku 5

Parashtresa pranë Komisionit shpesh dorëzohet në mënyrë tradicionale përkatësisht me postë ose personalisht në hapësirat e Komisionit (245 parashtresa, që është 60% e numrit të përgjithshëm të parashtresave të dorëzuara). Në mënyrë elektronike janë dorëzuar 160 parashtresa ose 40% prej të cilave 50 parashtresa janë dërguar në adresën elektronike ndërsa parashtresë elektronike (parashtresë-e) nëpërmjet shërbimit "Denonco diskriminim" në faqen e Komisionit kanë dorëzuar 110 persona (Grafiku 6). KPMD në vitin 2024, në mënyrë aktive ka punuar në përmirësimin e veglës për dërgim elektronik të parashtresave që mundëson çdo person, në çdo vend ose në çdo kohë, në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë, të denoncojë rast të diskriminimit.

Mjeti i ankesës elektronike është mënyra më e arritshme, më e shpejtë dhe më e thjeshtë për të raportuar diskriminimin, por qytetarët ende përdorin kryesisht metodat tradicionale të paraqitjes së ankesave.



Grafiku 6



Foto 1 – Dukja e ngjitësve me “kodin QR”

Në drejtim të ngritjes së ndërgjegjësimit publik për raportimin e diskriminimit, KPMD krijoi “kode QR” në formë të ngjitësve të vegjël, nëpërmjet të cilave qytetarët mund të lidhen shpejt me sistemin elektronik dhe të raportojnë diskriminimin. Ata u dorëzuan në Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës, Ministrinë e Politikës Sociale, e Demografisë dhe të Rinjve, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Agjencinë e Punësimit, për t’i shpërndarë ato në të gjitha institucionet nën kompetencën e tyre, pra në shkolla, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore, qendrat e punësimit dhe të tjera.

Krahas 405 parashtresave të reja, KPMD-ja ka vepruar edhe ndaj 77 parashtresave të paraqitura në vitin paraprak, kështu që në vitin 2024 janë proceduar gjithsej 482 parashtresave.

### Të dhënat demografike për parashtresat e paraqitura


Një anketë demografike është pjesë përbërëse e formularit<sup>1</sup> për paraqitjen e parashtresave. Ajo nuk është një element i detyrueshëm i ankesës, dhe nëse paraqitësit vendosin ta plotësojnë, kjo i mundëson KPMD-së qasje në të dhëna shtesë që mblidhen, ruhen dhe përpunohen ekskluzivisht për qëllime analitike dhe në përputhje me rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale. Përveç informacioneve të përgjithshme statistikore, të dhënat demografike në raste të caktuara mund të jenë të dobishme për Komisionin si një sinjal i hershëm për mundësinë e diskriminimit ndërkufitar. Në këtë raport paraqitet statistika e ankesave të paraqitura nga individë sipas gjinisë, përkatësisë etnike dhe moshës së paraqitësit (ose të personit në emër të të cilit paraqitet ankesa nëse si paraqitës është një individ apo person juridik i autorizuar).

Nga gjithsej 351 individë për të cilët është paraqitur një parashtresë për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2024, për 16 individë nuk është i njohur informacioni për gjininë. Nga të tjerët, numri i parashtresave të paraqitura është **pothuajse identik mes meshkujve dhe femrave** (Grafiku 7), pra 169 paraqitës ishin meshkuj (50,4%) dhe 166 femra (49,6%).

---

<sup>1</sup> Nga parashtresat që janë paraqitur në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal në hapësirat e Komisionit, nëse nuk shprehen qartë, nuk mund të sigurohen të dhëna demografike direkte nga parashtresa. Në një numër të caktuar rastesh, të dhënat merren më vonë, gjatë procesit, ndërsa në raste të tjera KPMD-ja nuk arrin t’i sigurojë deri në fund të procedurës.

## Femrat dhe meshkujt në mënyrë të barabartë paraqesin ankesa për t'u mbrojtur nga diskriminimi




Grafiku 7

Në lidhje me përkatësinë kombëtare, 124 parashtreses ose 35% nuk janë deklaruar. Nga ata që janë deklaruar, 169 ishin maqedonas, 29 shqiptarë, 8 vlleh, 7 romë, 3 turq, 2 serb dhe 1 boshnjak. Komisionit i janë dorëzuar gjithashtu 8 parashtresa nga qytetarë që kanë deklaruar përkatësi tjetër etnike (bullgare, kroate, gorane, amerikane, kanadeze, ruse dhe dy parashtreses që kanë zgjedhur përkatësi tjetër etnike pa e specifikuar atë). Në Grafikon 8 është paraqitur përkatësia etnike e paraqitësve të parashtresave të shprehur në përqindje.


## Të dhënat e përkatësisë etnike nuk u dorëzuan nga 35% e aplikantëve

Përkatësi tjetër etnike: kroate, amerikane, kanadeze, gorane, bullgare, ruse dhe përkatësi të tjera konkretisht të paspecifikuara



Grafiku 8

Të dhëna për moshën nuk kanë dorëzuar 93 parashtreses të parashtresave. Nga parashtresët për të cilët dihet moshja, shumica janë në moshën 41-50 vjeç, më pas vijojnë parashtresët e moshës 31-40 vjeç dhe 51-60 vjeç. Në Grafikon 9 është paraqitur pasqyrë e plotë e numrit të parashtresëve sipas moshës në grupe moshe.



*Grafiku 9*

### Harta gjeografike e parashtruesve të parashtrësve

Harta gjeografike e parashtruesve të parashtrësve është një vizualizim i numrit të parashtrësve që bazohet në të dhënat e adresës së parashtruesve – për personat fizikë kjo është komuna e banimit/qëndrimit, ndërsa për personat juridikë komuna e selisë. Në këtë raport paraqitet harta gjeografike e parashtrësve të dorëzuara sipas rajoneve dhe komunave.

Sa i përket rajoneve planore, numri më i madh i parashtrësve për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2024 deri te KPMD është dorëzuar nga qytetarë dhe organizata me adresë/seli në komunat e Rajonit planor të Shkupit – 223 parashtrës ose 55% (Grafiku 10). Numri i parashtrësve nga rajonet tjera është si vijon:

- 39 ose 9,6% nga komunat në Rajonin planor të Pellagonisë
- 31 ose 7,6% nga komunat në Rajonin planor Jugperëndimor
- 27 ose 6,7% nga komunat në Rajonin planor të Pollogut
- 25 ose 6,2% nga komunat në Rajonin planor të Vardarit
- 19 ose 4,7% nga komunat në Rajonin planor Lindor
- 14 ose 3,5% nga komunat në Rajonin planor Verilindor, dhe
- 10 ose 2,5% nga komunat në Rajonin planor Juglindor

## Ankesa për mbrojtje nga diskriminimi u dorëzuan nga aplikantë nga të gjitha rajonet.




Grafiku 10

Sa i përket komunave, numri më i madh i parashtresave në vitin 2024 është dorëzuar nga qytetarë dhe organizata me adresë/seli në Shkup – 217 parashtresa, ose 54% (Grafiku 11). Numri i parashtresave nga komunat e tjera është si vijon:

- nga 21 parashtresa nga Manastiri dhe Ohri
- nga 12 parashtresa nga Velesi dhe Tetova
- 10 nga Prilepi
- 9 nga Kumanova
- 8 nga Gostivari
- nga 7 nga Kavadarci dhe Shtipi
- 6 nga Kërçova
- 4 nga Koçani
- nga 3 nga Berova, Bërvenica, Gjevgjelia, Demir Hisari, Krusheva dhe Negotina
- nga 2 nga Haraçina, Vrapçishti, Dellçeva, Ilindeni, Kriva Pallanka, Makedonski Brodi, Pehçeva, Rankovci dhe Strumica
- nga 1 parashtresë nga Vasileva, Dibra, Demir Kapia, Dojrani, Dollneni, Konçeja, Kratova, Mavrova dhe Rostusha, Makedonska Kamenicë, Novo Sellë, Petroveci, Radovishi, Resnja, Rosomani, Struga, Studeniçani, Tearca dhe Çashka.

Ankesa për mbrojtje nga diskriminimi u dorëzuan nga aplikantë nga 63% e komunave në vend.



Grafiku 11

Në vitin 2024, pranë Komisionit janë paraqitur edhe 9 parashtresa për mbrojtje nga diskriminimi nga një organizatë qytetare me seli në Bruksel, Belgjikë; nga një parashtresë kanë dorëzuar persona nga Gjermania, Norvegjia dhe Kosova, ndërsa 5 persona kanë dorëzuar parashtresë pa përfshirë të dhëna të adresës, e cila është element i detyrueshëm i parashtresës.


## Bazat dhe fushat e raportuara të diskriminimit në lëndët e reja për vitin 2024

KPMD-ja në shkurt të vitit 2024 ka pranuar 56 parashtresa me përmbajtje identike, të paraqitura nga një grup i punësuarish në Drejtorinë e të Hyrave Publike kundër Sindikatës së SPOGJ-it për diskriminim të kryer mbi bazë të bindjeve të tjera në fushën e anëtarësimit dhe veprimit në sindikata, parti politike, shoqata qytetare dhe fondacione ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësim. Duke pasur parasysh që të gjitha kishin të bëjnë me të njëjtën çështje juridike, Komisioni solli një përfundim me të cilin procedurat e nisura për mbrojtje nga diskriminimi për këto 56 parashtresa bashkohen në një procedurë të vetme. Edhe pse të bashkuara në një procedurë, të dhënat e përfshira në këto parashtresa marrin pjesë statistikisht në analizën për praninë e bazave dhe fushave të raportuara të diskriminimit në parashtresat e dorëzuara. Duke pasur parasysh se numri i këtyre parashtresave përbën 14% të gjithsej parashtresave të dorëzuara në vitin 2024, baza e raportuar “bindje tjetër” dhe fusha e raportuar “anëtarësim dhe veprim në sindikata, parti politike, shoqata të qytetarëve dhe fondacione apo organizata të tjera të bazuara në anëtarësim” janë dukshëm të theksuara në statistikat e përgjithshme për bazat dhe fushat e raportuara të diskriminimit në vitin 2024, veçanërisht për parashtresat e dorëzuara nga persona fizikë. Përveç 56 parashtresave të përmendura, gjatë vitit 2024, KPMD ka pranuar edhe në katër raste nga dy parashtresa për ngjarje të njëjta, dhe për këto paraqitje të dyfishta, Komisioni gjithashtu solli përfundim për bashkimin e tyre në një procedurë të vetme.

## Bazat e parashtruara të diskriminimit

**Baza më shpesh e denoncuar për diskriminim në vitin 2024 ishte përkatësia kombëtare ose etnike**, e cila është theksuar në 109 parashtresa, që është 27% e numrit të përgjithshëm të parashtresave (Grafiku 12). Kjo pasohet nga raportet për diskriminim për baza të tjera (19%), besim tjetër (17%), karakteristika personale dhe status social (14%), bindje politike (11%), arsim (7%) dhe gjini (5%). Diskriminim është denoncuar edhe për 16 baza të tjera, por ato përbënin më pak se 5% të parashtresave të paraqitura. Në 28 parashtresa (7%) parashtruesi nuk ka deklaruar arsye diskriminuese në parashtresë.


Përkatësia etnike është arsyeja më e raportuar  
për diskriminim në vitin 2024



*Grafiku 12*

Në 109 parashtresa ose 27% të rasteve, parashtruesit kanë shënuar më shumë se një bazë dhe të njëjtat mund të jenë një tregues i mundshëm për raste të diskriminimit të shumëfishtë ose ndërseksional. Kështu, për shembull, janë paraqitur 6 parashtresa për diskriminim mbi bazë të përkatësisë kombëtare ose etnike dhe të gjuhës, 4 parashtresa për diskriminim mbi bazë të përkatësisë kombëtare ose etnike dhe bindjeve politike, pastaj 3 parashtresa për diskriminim mbi bazë të përkatësisë kombëtare ose etnike dhe ngjyrës së lëkurës, 3 parashtresa për diskriminim mbi bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, 2 parashtresa për diskriminim mbi bazë të përkatësisë kombëtare ose etnike dhe fesë ose bindjeve fetare etj. Kjo duhet pasur parasysh pasi në prezantimin statistikor të bazave të diskriminimit paraqitet numri i përgjithshëm i parashtresave në të cilat është raportuar baza përkatëse. (Grafiku13).

## Numri i parashtresave sipas bazave të raportuara Në 27% të parashtresave, aplikantët treguan arsye të shumta



Grafiku 13

Sa i përket bazave të denoncuara të diskriminimit të Femrat dhe meshkujt, në vitin 2024, Femrat më shpesh sesa meshkujt kanë raportuar diskriminim mbi bazë të gjinisë, identitetit gjinor, arsimit, moshës dhe statusit familjar ose martesor, ndërsa meshkujt më shpesh sesa Femrat kanë paraqitur parashtresa për mbrojtje nga diskriminimi mbi bazë të ngjyrës së lëkurës, prejardhjes, orientimit seksual, përkatësisë në një grup të marginalizuar, shtetësisë dhe aftësisë së kufizuar. Në Tabelën 1 është paraqitur numri i parashtresave sipas bazës së raportuar të personat juridikë dhe fizikë, të ndarë sipas gjinisë së parashtresës.

### Numri i parashtresave në secilën nga bazat e denoncuara të diskriminimit sipas parashtresës të parashtresës


Baza e denoncuar/ Statusi i parashtresës	Persona fizikë			Personat juridikë
	Femra	Meshkuj	Nuk ka të dhëna për gjininë	
Raca	1	0	0	3
Ngjyra e lëkurës	1	3	0	1
Prejardhja	0	3	0	1
Përkatësia kombëtare ose etnike	32	37	5	35

Gjinia	15	7	0	0
Identiteti gjinor	12	2	0	0
Orientimi seksual	1	14	1	4
Identiteti gjinor	3	4	1	3
Përkatësia në grup të marginalizuar	0	6	0	4
Gjuha	3	5	1	3
Shtetësia	0	6	0	2
Prejardhja sociale	5	5	0	1
Arsimi	18	10	1	1
Feja ose bindjet fetare	10	8	0	1
Bindjet politike	18	23	3	2
Bindje të tjera	39	29	0	0
Aftësia e kufizuar	5	10	1	2
Mosha	12	7	0	0
Statusi familjar ose martesor	7	3	0	0
Statusi pasuror	3	5	0	0
Gjendja shëndetësore	5	8	0	0
Tipari personal dhe statusi shoqëror	21	34	1	2
Bazë tjetër	34	34	2	6

Tabela 1 – Numri i parashtrësive të dorëzuara për secilën nga bazat sipas llojit të parashtruesit

## Fushat e denoncuar të diskriminimit

Më së shumti parashtrësia për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2024 kanë qenë në fushën e punës dhe të marrëdhënieve të punës, e cila është theksuar në 39% të numrit të përgjithshëm të parashtrësive të dorëzuara. (Grafiku 14).




Grafiku 14

Më pas, vijnë parashtresat në fushat e anëtarësimit dhe veprimtarisë në sindikata, parti politike, shoqata qytetarësh dhe fonde ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësim (16%), informimi publik dhe media (13%) dhe fushat e tjera (12%). Diskriminimi është raportuar gjithashtu në fushat e arsimit, shkencës dhe sportit (9%), qasjes në mallra dhe shërbime (8%), drejtësisë dhe administratës (8%), sigurisë sociale, duke përfshirë fushën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor (6%), strehimin (4%) dhe kulturën (1%). Nuk është shënuar asnjë fushë diskriminimi në 5 parashtresa të dorëzuara. Pasqyra e plotë e numrit të parashtresave për secilën nga fushat e raportuara të diskriminimit është paraqitur në Grafiku 15.

## Numri i parashtresave sipas fushës së denoncuar

Në 10% të parashtresave, parashtresuesit kanë nënvizuar më shumë se një fushë



Grafiku 15

Njëjtë si me bazat, parashtruesit në parashtresa shënojnë më shumë fusha të mundshme diskriminimi, dhe ky është rast për 41 parashtresa, që përbëjnë 10% të numrit të përgjithshëm të parashtresave të dorëzuara. Shembuj të tillë janë 4 parashtresa, në të cilat janë denoncuar fushat e punës dhe të marrëdhënieve të punës, dhe arsimit, shkencës dhe sportit; pastaj në 3 parashtresa janë shënuar fushat e arsimit, shkencës dhe sportit dhe qasja në mallra dhe shërbime; në 2 parashtresa janë denoncuar fushat e punës dhe marrëdhënieve të punës, dhe anëtarësimit dhe veprimtarisë në sindikata, parti politike, shoqata qytetarësh dhe fonde ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësim, etj.

Puna dhe marrëdhëniet e punës, si fusha më shpesh e denoncuar e diskriminimit, janë shënuar thuajse njësoj në parashtresat e grave dhe burrave, me pak më shumë parashtresa të dorëzuara nga Femrat (Tabela 2). Femrat më shpesh se meshkujt kanë raportuar diskriminim edhe në fushat

e informimit publik dhe medias, si dhe anëtarësimit dhe veprimtarisë në sindikata, parti politike, shoqata qytetarësh dhe fonde ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësim, ndërsa meshkujt më shpesh se femrat kanë dorëzuar parashtrësia për mbrojtje nga diskriminimi në fushat e arsimit, shkencës dhe sportit, strehimit, qasjes në mallra dhe shërbime, si dhe sigurisë sociale, përfshirë fushën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensionist dhe invalid, sigurimin shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor.

Numri i parashtrësive në secilën nga fushat e denoncuar të diskriminimit sipas parashtrësit të parashtrësës					
Baza e denoncuar/ Lloji i parashtrësit	Persona fizikë			Persona juridikë	Gjithsej
	Femra	Meshkuj	Nuk ka të dhëna për gjininë		
Puna dhe marrëdhëniet e punës	73	69	7	10	159
Arsimi, shkenca dhe sporti	11	22	2	3	38
Siguria sociale, përfshirë fushën e mbrojtjes sociale, sigurimin pensional dhe invalidor, sigurimin shëndetësor dhe kujdesin shëndetësor	9	12	0	4	25
Gjyqësori dhe administrata	12	13	1	5	31
Strehimi	3	10	1	3	17
Informimi publik dhe mediat	18	12	0	21	51
Qasja në mallra dhe shërbime	9	18	1	6	34
Anëtarësimi dhe veprimtaria në sindikata, parti politike, shoqata qytetarësh dhe fonde ose organizata të tjera të bazuara në anëtarësim	38	25	0	1	64
Kultura	1	1	0	1	3
Fusha tjetër	18	21	3	6	48

Tabela 2 - Numri i parashtrësive të dorëzuara në secilën nga fushat sipas llojit të parashtrësit

## Procedura për mbrojtje nga diskriminimi të nisura nga detyra zyrtare

Sipas nenit 21, paragrafi 1, pika 15 e Ligjit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, KPMD fillon procedurën për mbrojtje nga diskriminimi nga detyra zyrtare. Komisioni e nis këtë procedurë nëse nga rrethanat dhe faktet, si dhe nga njohuritë e marra përmes informacioneve, del se është kryer diskriminim në përputhje me bazat diskriminuuese.

Sipas Ligjit, të gjitha personat fizikë dhe juridikë, organet shtetërore, organet e njëjësive të vetëqeverisjes lokale, organet dhe organizatat të cilat ushtrojnë pushtete publike dhe

institucionet dhe shërbimet publike, janë të detyruara që, me kërkesë të Komisionit, të japin të dhëna për raste konkrete diskriminimi dhe praktikat e përgjithshme të diskriminimit brenda një periudhe prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës. Në vitin 2024, tetë raste tërhoqën vëmendjen e Komisionit për të hyrë aktivisht në grumbullimin e të dhënave dhe provave për të mundësuar nisjen e procedurave për mbrojtje nga diskriminimi nga detyra zyrtare, dhe këto janë:

- Kërkesa për të dhëna dhe informacion nga autoritetet kompetente për diskriminimin potencial etnik në qasjen në arsimin fillor, lidhur me protestën në SHFK "Todor Janev" në Komunën e Çashkës kundër vendimit për krijimin e një paraleleje në gjuhën mësimore shqipe, e organizuar nga një grup qytetarësh të vendbanimit Çashkë, e cila ngjarje u raportua në një numër të madh mediash.
- Kërkesë për grumbullimin e të dhënave dhe informacioneve për mundësinë e veçimit etnik ndaj nxënësve të kombësisë turke në shkollën rajonale "Almanah" në fshatin Dërzhillovë pranë SHFK "Draga Stojanovska" në Sopishte, lidhur me publikimin në mediat elektronike Portali X më 25.4.2024 me titullin "Në tabelën e maturës nuk ka vend për nxënësit e kombësisë turke".
- Kërkesë për të dhëna dhe informacione nga institucionet kompetente për diskriminimin potencial etnik ndaj banorëve të fshatit Kazandoll, Vallandovë, të cilët janë të kombësisë turke, në qasjen në të mira dhe shërbime publike, lidhur me publikimin në mediat elektronike "Anadolu Azhansi" me titull "Fshati Kazandol i Vallandovës në shekullin 21 pa ujë dhe me rrjet elektrik të pasigurt".
- Kërkesë për të dhëna nga institucionet kompetente për mundësinë e diskriminimit në qasjen në arsimin fillor të detyrueshëm bazuar në aftësitë e kufizuara, lidhur me vonesën në sigurimin e asistentëve edukativë që mbështesin mësuesit në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara, e publikuar si informacion më 2.9.2024, në lajmet e Televizionit 24 dhe portalin e tij [www.24.mk](http://www.24.mk) me titullin "Viti shkollor nisi pa asistentë edukativë dhe personalë, prindërit të revoltuar, ministrja i qetëson".
- Kërkesë për të dhëna dhe informacione nga institucionet kompetente për mundësinë e diskriminimit etnik në qasjen në arsimin fillor të detyrueshëm në SHFK "Rade Kratovçe" nga Koçani, lidhur me lajmin e publikuar në portalin e internetit [www.radiokocani.mk](http://www.radiokocani.mk) me titullin "Incident në SHFK "Rade Kratovçe" – A ka diskriminim ndaj nxënësve të kombësisë rome?".
- Kërkesë për informacion nga institucionet kompetente për mundësinë e diskriminimit etnik në fushën e marrëdhënieve të punës, lidhur me lajmin e publikuar në Portalin X për rastin e largimit nga puna të punonjësve të kombësisë shqiptare në ISHP KU Biokimia Klinike – Shkup.
- Kërkesë për të dhëna nga institucionet kompetente për mundësinë e diskriminimit në qasjen në arsimin fillor të detyrueshëm, lidhur me informacionin e marrë se prindërit e nxënësve në SHFK "Llazo Angelovski", komuna e Aerodromit, Shkup, protestojnë dhe

firmosin petition për të siguruar që një nxënëse nga e njëjta klasë të mos e ndjekë mësimin derisa të sigurohet asistent edukativ i ri, pasi i mëparshmi ka dhënë dorëheqje. Pra, në një ankesa nga viti 2024, u përfshinë indikacione për mundësinë e diskriminimit ndaj një nxënësi në arsimin fillor, për të cilin shkolla (SHFK "Vera Ciriviri-Trena" në Shkup), sipas informacioneve në parashtresë, nuk e lejon të ndjekë mësimin. Duke marrë parasysh se parashtruesi nuk kishte distinktiv aktiv, KPMD i trajtoi pohimet në parashtresë si informacione të marrë sipas zërave dhe u përfshi në grumbullimin e të dhënave shtesë për të mundësuar nisjen e një procedure për mbrojtje nga diskriminimi, në përputhje me detyrat zyrtare.

Nga këto tetë ngjarje, KPMD në vitin 2024 ka formuar dhe nisur dy procedura për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrës zyrtare, dhe ato janë: për rastin e vonesës në sigurimin e asistentëve edukativë që mbështesin mësuesit në punën me nxënësit me aftësi të kufizuara në arsimin fillor dhe për mundësinë e veçimit të nxënësve nga etnia rome në SHFK "Rade Kratovçe" nga Koçani.

Për gjashtë rastet e tjera, deri në fund të vitit, KPMD nuk mori një vendim për nisjen e procedurave sipas detyrës zyrtare, kështu që aktivitetet do të vazhdojnë në vitin tjetër 2025.


Krahas dy procedurave të formuara të reja, të përmendura, në vitin 2024, KPMD-ja vazhdoi procedurën e iniciuar sipas detyrës zyrtare dhe për lëndën që ka qenë e formuar në vitin paraprak për diskriminim të mundshëm të tërthortë në bazë të gjinisë, identitetit gjinor, cilësisë personale dhe gjendjes së statusit pasuror në fushën e arsimit që rrjedhin nga dispozitat e Rendit shtëpiak të ShMKGj "Mirçe Acev" nga Prilepi, dhe kanë të bëjnë me paraqitjen e jashtme të studentëve. Kështu, në vitin 2024, KPMD-ja ka punuar dhe ka vendosur për gjithsej tri procedura për mbrojtje nga diskriminimi sipas detyrimit zyrtar.

## Vendimmarrja nga Komisioni sipas lëndëve për mbrojtje nga diskriminimi

Për ankesat të cilat janë paraqitur në rregull, me kohë dhe në pajtim me ligjin, Komisioni zhvillon procedurë për konstatimin e diskriminimit, e cila përfundon me miratimin e mendimit juridik me të cilin përcaktohet ose nuk përcaktohet diskriminimi, në të kundërtën merret vendim për refuzimin, mosveprimin ose ndërprerjen e procedurës.

Në vitin 2024, KPMD-ja ka punuar në gjithsej 485 lëndë për mbrojtje nga diskriminimi dhe në 24 seancat e mbajtura janë miratuar **316 vendime**. Për faktin se për disa nga ankesat që paraqisnin paraqitje të shumta për të njëjtën çështje ligjore, KPMD-ja ka vepruar dhe i ka vendosur në një procedurë të vetme, dhe bëhet me dije se me 316 vendimet e marra në vitin 2024 janë **mbyllur gjithsej 375 lëndë** për mbrojtje nga diskriminimi. Procedura për 110 ankesat e mbetura vazhdon në vitin 2025.

Në vitin 2024, nga gjithsej 316 vendime të miratuara, 152 ose 48% janë mendime sipas procedurës së zbatuar për konstatimin e diskriminimit dhe 164 ose 52% janë konkluzat për refuzimin e ankesës, pra për të mos vepruar ose për të ndërprerë procedurën (Grafiku 16).



Grafiku 16

Konkluzat e miratuara nga KPMD-ja, e cila hodhi poshtë disa ankesa, gjegjësisht vendosi të mos procedojë apo të ndërpresë procedurën, janë kryesisht për shkak të parregullsisë së parashtrësës (72 ose 44%) dhe për shkak të mungesës së kompetencës së Komisionit për të vepruar (63 ose 38%). Grafiku 17 ofron pasqyrë të detajuar të numrit të konkluzioneve të tilla sipas bazës për vendimmarrje në pajtim me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi. Komisioni investon në burime për të përmirësuar dhe thjeshtuar procesin e paraqitjes së ankesave duke ofruar konsultime profesionale për qytetarët e interesuar në hapësirat e Komisionit ose nëpërmjet kanaleve të ndryshme të vendosura të komunikimit (telefon dhe e-mail), më pas duke shkëmbyer informacione me publikun, duke mbajtur takime dhe trajnime informative, si dhe përmirësime teknike në paraqitjen elektronike të ankesave. Për të gjitha ankesat për të cilat KPMD-ja nuk ka mundur të zbatojë procedurë, janë dorëzuar përgjigje të arsyetuara drejtuar parashtruesve dhe janë ofruar informacione dhe udhëzime të përgjithshme se me cilin organ publik duhet kontaktuar për të realizuar të drejtat e tyre.

Shumica e ankesave të refuzuara janë për shkak se **nuk përmbajnë të gjithë elementet e detyrueshme** ose parashtruesi nuk e ka rregulluar pasi i është kthyer ose për shkak se Komisioni **nuk ka kompetencë** për të vepruar.



Grafiku 17

Sipas lëndëve për të cilat janë zbatuar procedura për konstatimin e diskriminimit dhe është miratuar opinion në vitin 2024, është konstatuar diskriminim në 56 raste ose 37%, dhe në 96 raste ose 63%, nuk është konstatuar diskriminim (Grafiku 18).

Në vitin 2024, KPMD lëshoi 152 mendime mbi procedurën e përcaktimit të diskriminimit



Grafiku 18


### Diskriminimi i konstatuar në vitin 2024

Në vitin 2024, Komisioni miratoi 56 mendime që konstatuan diskriminim dhe bënë rekomandime për eliminimin e tyre. Shumica e rasteve të konstatuara janë bazuar në ankesat e paraqitura nga personat fizikë (35 mendime ose 63%), pasuar nga rastet e konstatuara në bazë të ankesave nga personat juridikë (18 mendime ose 32%), si dhe procedurat e iniciuara nga KPMD-ja sipas detyrës zyrtare (3 mendime ose 5%). Nga mendimet për ankesat e paraqitura nga personat fizikë, 30 ose 86% i referohen diskriminimit të konstatuar ndaj personit që ka paraqitur ankesën, dhe në 5 rastet e mbetura ose 14%, është konstatuar diskriminim ndaj fëmijëve të parashtruesve.

## Llojet e diskriminimit në rastet e vërtetuara në vitin 2024

Në mendimet e KPMD-së të miratuara në vitin 2024, diskriminimi më së shpeshti është konstatuar në një formë konkrete (49 raste ose 87.5%), por në raste të caktuara është konstatuar se viktimat janë ekspozuar ndaj diskriminimit në disa forma të ndryshme (7 raste ose 12.5%). **Lloji më i përhapur është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i konstatuar në 33 mendime ose 59% të numrit të përgjithshëm të rasteve (Grafiku 19).**

Nga rastet e identifikuara në vitin 2024, gati 6 nga 10 janë forma të drejtpërdrejta të diskriminimit



Grafiku 19

Në 9 nga 33 rastet e konstatuara të diskriminimit të drejtpërdrejtë (27%), e njëjta është në formë më të rëndë, nga të cilat 4 janë diskriminim ndërseksional dhe pjesa tjetër në formën e diskriminimit të vazhdueshëm dhe të shumëfishtë (Grafiku 20). Në 3 raste, përveç diskriminimit të drejtpërdrejtë është konstatuar se diskriminuesi ka kryer edhe ngacmimin, viktimizimin dhe thirrjen, nxitjen dhe udhëzimin për diskriminim, ndërsa në njërin nga rastet KPMD-ja ka konstatuar diskriminim të drejtpërdrejtë në formë veçimi.

27% e rasteve të diskriminimit të drejtpërdrejtë janë në formë më të rëndë, dhe në 1 rast përcaktohet në formën e veçimit



Grafiku 20

Ngacmimi për baza diskriminuuese është lloji i dytë më i zakonshëm i diskriminimit në vitin 2024, i identifikuar në 14 raste ose 25% (Grafiku 21). Krahas dy rasteve të përmendura më parë të diskriminimit të drejtpërdrejtë, është vërtetuar edhe në tetë raste si formë konkrete, pastaj në dy raste së bashku me thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim, në një rast së bashku me thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim dhe viktimizim, si dhe në të fundit si ngacmim dhe viktimizim. Nga ana tjetër, **thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim është konstatuar në 8 raste ose 14%**, dhe atë e pranishme në një rast të diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe tre raste të ngacmimit, por është përcaktuar edhe si formë parësore e diskriminimit në katër raste të tjera. **Viktimizimi është përcaktuar në tre raste në vitin 2024**, përkatësisht në një rast të diskriminimit të vazhdueshëm me perceptim, ngacmim dhe viktimizim, një rast të ngacmimit dhe viktimizimit dhe një rast të ngacmimit, thirrjes, nxitjes dhe udhëzimit për diskriminim dhe viktimizim.



Grafiku 21

**Diskriminimi i tërthortë u konstatua në 7 raste nga numri i përgjithshëm i rasteve ose 11%**, nga të cilat në tre raste u konstatua si diskriminim në një formë më të rëndë - dy si diskriminim i shumëfishtë i tërthortë dhe një rast i diskriminimit të vazhdueshëm të tërthortë që çoi në veçim (Grafiku 22). Diskriminimi i tërthortë i konstatuar në vitin 2024, në katër raste rrjedh nga dispozitat në ligje, në një rast nga dispozitat në një akti nënligjor, dhe dy të tjerat janë për dispozita në aktet e brendshme të miratuara. Lënda e mendimeve profesionale në të cilat KPMD-ja përcaktoi diskriminim të tërthortë pas ankesave të parashtruara në vitin 2024 ishin dispozitat e Ligjit të Arsimit Fillor, Ligjit të Arsimit të Lartë, Ligjit të Kulturës dhe Ligjit të Nëpunësve Administrativë, pastaj Rregullorja për mënyrën e zbatimit të përzgjedhjes gjatë shpërndarjes, si


dhe gjatë avancimit dhe mënyrës së zbatimit të sistemit të karrierës së punëtorëve në Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe nga aktet e brendshme, që ishin dispozita në Rregulloren e miratuar të Shtëpisë në tre shkolla të mesme.

Diskriminim i tërthortë u konstatua në 7 raste, 3 prej të cilave në një formë më serioze si diskriminim i shumëfishtë dhe i vazhdueshëm, dhe një prej tyre është rast i diskriminimit të tërthortë që çon në veçim



Grafiku 22

Format më të rënda të diskriminimit, siç janë diskriminimi ndërseksional, ai i vazhdueshëm ose i shumëfishtë, u përcaktuan në 12 raste, që përbën 21% të numrit të përgjithshëm të rasteve të konfirmuara të diskriminimit në vitin 2024 (Grafiku 23).




Grafiku 23

### Bazat e diskriminimit në rastet e përcaktuara në vitin 2024

Përkatësia nacionale ose etnike është shkak më i shpeshtë i konstatuar për diskriminim në mendimet e Komisionit në vitin 2024, duke përbërë 25% të totalit të rasteve të konstatuara. Kjo pasohet nga bazat në vijim si: cilësia personale dhe statusi shoqëror (17%), baza të tjera (18%), gjinia (16%), identiteti gjinor (14%), orientimi seksual (13%), bindjet politike (13%) dhe aftësia e kufizuar (9%). Diskriminimi është konstatuar edhe në 10 baza të tjera të diskriminimit, të cilat përfaqësohen në më pak se 5% të mendimeve të miratuara nga Komisioni. Pasqyra e plotë e

numrit të mendimeve në të cilat është përcaktuar secila nga bazat e diskriminimit është dhënë në Grafikon 24.



Grafiku 24


Lidhur me mendimet e përcaktuara me baza të tjera diskriminimi dhe bazat e cilësisë personale dhe statusit shoqëror, në 5 raste bazat ishin cilësitë e anëtarësimit ose mosanëtarësimit në organizatë sindikale, dhe mendimet e mbetura radhiten si më poshtë: amësia, shtatzënia e planifikuar, zhvillimi motorik i vonuar, problemet e të folurit dhe disleksia, vendi i banimit, statusi i nëpunësve administrativë të punësuar në institucione të sektorit publik me numër të vogël nëpunësish administrativë, shkalla e arsimimit, përgatitja profesionale dhe përvoja e punës, lloji i marrëdhënies së punës të vendosur dhe pamundësi të qasjes në vendin e punës.

Në 23 raste ose 41% të mendimeve të miratuara, Komisioni konstatoi diskriminim për dy dhe më shumë baza. Përkatësia etnike, në 8 nga gjithsej 14 mendime të miratuara, përcaktohet së bashku me disa baza të tjera (ngjyra e lëkurës, raca, gjuha, origjina sociale, statusi pasuror dhe të tjera), nga të cilat në 2 raste si diskriminim në formë më të rëndë, përkatësisht diskriminim ndërseksional bazuar në përkatësi etnike dhe gjini, si dhe diskriminim të shumëfishtë dhe të vazhdueshëm sipas perceptimit bazuar në përkatësinë etnike dhe racë, orientimi seksual dhe aftësitë e veçanta. Diskriminimi bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, si rast diskriminimi mbi dy baza, është konstatuar në 5 mendime. Veçanërisht i veçojmë dhe i përcaktojmë 4 rastet e diskriminimit ndërseksional, si diskriminim mbi dy ose më shumë baza

diskriminuere që janë të lidhura njëkohësisht dhe në mënyrë të pandashme, përkatësisht në bazë të gjinisë dhe të amësisë, pastaj në bazë të gjinisë, gjinisë dhe shtatzënisë së planifikuar, në bazë të gjinisë dhe përkatësisë etnike, dhe në bazë të gjinisë dhe religjionit ose besimit fetar.

## Fushat e diskriminimit në rastet e përcaktuara në vitin 2024


Ashtu si në vitin e kaluar, në mendimet e KPMD-së në vitin 2024, **diskriminimi u gjet më shpesh në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës, në 24 raste ose 43% të numrit të përgjithshëm të mendimeve të miratuara.** Kjo pasohet nga rastet e diskriminimit të konstatuar në fushat e arsimit, shkencës dhe sportit (11 mendime ose 20%) dhe informacioni publik dhe media (11 mendime ose 20%). Pasqyra e plotë e numrit të mendimeve sipas fushave të identifikuara është dhënë në Grafikon 25.



Grafiku 25

Në 7 nga 56 mendimet e miratuara, Komisioni përcaktoi se diskriminimi ishte kryer në dy fusha, nga të cilat 3 raste diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe anëtarësimit dhe aktiviteteve të sindikatave, partive politike, shoqatave të qytetarëve dhe fondacioneve ose organizatave të tjera të bazuara në anëtarësim, pastaj 3 raste diskriminimi në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës dhe arsimit, shkencës dhe sportit dhe 1 rast diskriminimi në fushën e strehimit dhe sigurimeve sociale, duke përfshirë fushën e mbrojtjes shoqërore, sigurimit pensional dhe invalidor, sigurimit shëndetësor dhe kujdesit shëndetësor.

Ashtu si në vitin e kaluar, numri më i madh i rasteve të konstatuara të diskriminimit në vitin 2024 ishte në institucionet e sektorit publik (37 raste ose 66%), ndërsa realizuesit ishin institucionet, drejtuesit e tyre dhe persona të tjerë të autorizuar dhe të punësuar, si dhe rregulla të caktuara që rregullojnë kompetencën, përkatësisht kryerjen e aktiviteteve të institucioneve.



Grafiku 26

Diskriminimi në institucionet e sektorit publik identifikohet më shpesh në fushën e punës dhe të marrëdhënieve të punës ndaj të punësuarve në institucione (siç është diskriminimi ose ngacmimi në vendin e punës) dhe në procedurat për plotësimin e vendit të punës pas shpalljes për punë ose avancim (diskriminim në qasjen e punësimit). Numri më i madh i rasteve të diskriminimit në marrëdhëniet e punës në institucionet e sektorit publik u përcaktua në bazë të bindjeve politike, pastaj në anëtarësimin ose mosanëtarësimin në organizatë sindikale, dhe u përcaktua gjithashtu në bazë të aftësisë së veçantë, arsimit dhe bazave të tjera, si dhe një rast i diskriminimit ndërseksional bazuar në gjininë, dhe amësi. KPMD-ja konfirmoi gjithashtu diskriminim të tërthortë në fushën e shkencës dhe marrëdhënieve të punës, i cili rrjedh nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe rezulton në pamundësinë e të punësuarve në institucionet private të kujdesit shëndetësor, të cilët zgjidhen në pozicione mësimore-shkencore, mësimore-profesionale, mësimore dhe me titull bashkëpunimi, për të kryer veprimtari të arsimit të lartë dhe atij kërkimor-shkencor në institucion publik të arsimit të lartë për shkak të llojit të marrëdhënies së punës së krijuar.

Fusha e dytë më e identifikuar e diskriminimit në sektorin publik është arsimiti. Janë identifikuar raste të veçimit në baza etnike kundrejt nxënësve të etnisë rome, që në mënyrë të tërthortë vijnë si rezultat i dispozitave në Ligjin e Arsimit Fillor, si dhe rast i diskriminimit të drejtpërdrejtë-veçimit në të cilin autori është në shkollë filllore në Koçan. Gjithashtu, u identifikuan raste të diskriminimit të tërthortë ndaj nxënësve në tre shkolla të mesme në bazë të gjinisë, identitetit gjinor, cilësisë personale dhe statusit pasuror që rrjedhin nga dispozitat e rregullores së shkollës,

si dhe raste të diskriminimit të drejtpërdrejtë ose ngacmimit të kryer nga shkollat dhe personat e punësuar në to ndaj nxënësve në bazë të gjinisë, cilësisë personale dhe statusit shoqëror, dhe rast i diskriminimit të shumëfishtë të vazhdueshëm bazuar në perceptimin e përkatësisë etnike dhe racore, orientimit seksual dhe aftësisë së veçantë. Në procedurë të iniciuar sipas detyrës zyrtare, KPMD-ja përcaktoi diskriminimin e kryer nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës ndaj grupit të studentëve me aftësi të veçanta për shkak të vonësës në sigurimin e asistentëve arsimorë.

Në fushën e **gjqësorit dhe administratës**, u konfirmuan dy raste të diskriminimit ndaj banorëve të etnisë turke në bazë të gjuhës në komunat Vasilevë dhe Karbinci, për shkak të mos harmonizimit të punës së komunave me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Diskriminimi në bazë të gjuhës dhe përkatësisë etnike u konfirmua edhe në procesin e lëshimit të dokumenteve personale, të kryera nga Ministria e Punëve të Brendshme ndaj qytetarëve të RMV-së me përkatësi etnike turke. U konfirmua gjithashtu edhe rasti i diskriminimit bazuar në etni dhe racë, i kryer nga persona me autoritet policor dhe anëtarë të policisë së burgjeve kundër të miturve të etnisë rome.

Në fushën e **qasjes në mallra dhe shërbime të ofruara nga institucionet e sektorit publik**, janë identifikuar dy raste, njëri prej të cilëve është bazuar në ngjyrën e lëkurës dhe përkatësinë etnike nga ana e NTP-Shkup krahas banorëve të qytetit të Shkupit me përkatësi etnike rome dhe një rast i diskriminimit të drejtpërdrejtë bazuar në vendbanimin në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime të kryer nga ana e Komunës së Aerodromit krahas banorëve të vendbanimeve brenda Komunës së Aerodromit që nuk kanë parkim në zonë - (Vendbanimi) Lisiçe, Lisiçe e Re, Qendra Rajonal, Lisiçe e Epërme dhe Lisiçe e Poshtme.

Raste të tjera të diskriminimit të kryera nga institucionet e sektorit publik përfshijnë diskriminimin e drejtpërdrejtë të konstatuar në fushën e **strehimit dhe mbrojtjes sociale** të kryer nga komuna dhe organet e tjera kompetente shtetërore krahas banorëve të vendbanimit Tunel-Baraka në Komunën e Velesit, pastaj diskriminimin e tërthortë të konstatuar krahas bartësve të çmimeve shtetërore në fushën e **kulturës** në bazë të statusit tjetër që rrjedh nga dispozitat e Ligjit për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Kulturës, më tej, një rast diskriminimi në fushën e **mbrojtjes së fëmijëve** të kryer nga ana e kopshtit në Shkup kundër të miturit në bazë të aftësisë së veçantë mendore dhe fizike dhe gjendjes shëndetësore, si dhe përcaktimin e ngacmimit dhe thirrjen, nxitjen dhe udhëzimin për diskriminim në bazë të përkatësisë etnike në **fushën e informacionit publik dhe mediave** të kryera nga Komuna e Karposhit dhe kryetari i komunës kundër një grupi romësh.

**Diskriminimi në sektorin privat u konstatua në 9 raste ose 16% të totalit të mendimeve të miratuara**, në fushën e punës dhe të marrëdhënieve të punës, si dhe për shkak të refuzimit ose pengimit të qasjes në shërbimet e tyre mbi baza diskriminuuese. **Në fushën e punës dhe marrëdhënieve të punës në sektorin privat, u identifikuan 5 raste ose 26%**, nga të cilat dy raste identifikuan diskriminim ndërseksional ndaj punëtoreve femra, punësimi i të cilave u ndërpre - i pari bazuar në gjininë dhe shtatzëni të planifikuar të punonjësës, dhe i dyti bazuar në gjini dhe përkatësi etnike kundër gjashtë grave maqedonase. Në tre rastet e mbetura, njëra ka të

bëjë me diskriminimin bazuar në racë dhe përkatësi nacionale ose etnike në qasjen në punësim të qytetarit të përkatësisë etnike rome, një tjetër ka të bëjë me ngacmimin e të punësuarit bazuar në orientimin seksual dhe e fundit ka të bëjë me diskriminimin bazuar në bindjet politike në qasjen në punë. **Në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime në sektorin privat, u përcaktua në 3 raste, përkatësisht një rast diskriminimi ndërseksional ndaj një gruaje myslimane së cilës nuk iu lejua të hynte në një restorant në Shkup në bazë të gjinisë dhe religjionit ose besimit fetar, pastaj një rast diskriminimi në qasjen në shërbime në kafene në Shtip ndaj një personi të etnisë rome në bazë të përkatësisë nacionale ose etnike dhe ngjyrës së lëkurës, si dhe rast diskriminimi ndaj fëmijës të mitur në qasjen në shërbime në kënd lojërash në Shkup në bazë të aftësisë së veçantë mendore dhe fizike.** Rasti më i fundit i diskriminimit të konstatuar në sektorin privat është ai në **fushën e gjyqësorit dhe administratës** i kryer nga ana e Dhomës së Mjekëve, kundër qytetares bazuar në gjininë, e cila refuzoi të vendoste emrin e nënës së saj në lejen e punës, duke këmbëngulur që emri i babait të përfshihej patjetër.

**Diskriminimi në media dhe rrjetet sociale u përcaktua në 10 raste ose 18% të numrit të përgjithshëm të mendimeve të miratuara nga KPMD-ja në vitin 2024, si ngacmim ose fjalim mbi baza diskriminuese që bën thirrje, nxitje dhe jep udhëzime për ngacmim ose diskriminim.** Nga 10 mendimet e miratuara, Komisioni në 6 raste konfirmoi ngacmim dhe thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim në bazë të identitetit gjinor dhe orientimit seksual kundër personave LGBTI+, ngacmim në bazë të përkatësisë etnike të qytetarëve me origjinë bullgare u gjet në 2 raste, një rast është për thirrje, nxitje dhe udhëzim për diskriminim kundrejt anëtarëve të komunitetit etnik rom dhe të huajve me punë të përkohshme në RMV, si dhe një rast ngacmimi në bazë të përkatësisë etnike kundër maqedonasve të kryer gjatë një transmetimi të një podkasti në kanalën YouTube të administruar nga shoqata e qytetarëve.

### Statusi i plotësimin të rekomandimeve të Komisionit

Në pajtim me nenin 21, paragrafi 1, nënparagrafi 17 të Ligjit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, Komisioni monitoron realizimin e mendimeve dhe rekomandimeve për raste konkrete të diskriminimit deri në përmbushjen e rekomandimeve të dhëna. Personi të cilit i drejtohet rekomandimi është i detyruar të veprojë sipas rekomandimit dhe të eliminojë shkeljen e së drejtës brenda 30 ditëve nga data e marrjes së rekomandimit ose brenda një afati më të gjatë nëse ekzistojnë arsye veçanërisht të justifikuar, por jo më shumë se gjashtë muaj, si dhe ta njoftojë Komisionin për këtë. Nëse personi të cilit i drejtohet rekomandimi nuk vepron sipas rekomandimit, Komisioni paraqet kërkesë për të filluar procedurë kundërvajtjeje para gjykatës kompetente për kundërvajtje.

KPMD-ja monitoroi zbatimin e rekomandimeve të përfshira në mendimet e rasteve të përcaktuara në vitin aktual, si dhe ato të përcaktuara në vitin paraprak, afati i veprimit të të cilave skadoi në vitin 2024. Në periudhën raportuese, **Komisioni arriti në përfundimin se rekomandimet ishin përmbushur, gjegjësisht diskriminimi ishte mënjanuar në gjithsej 31 raste, nga të cilat 26 lidhen me rekomandimet e bëra në vitin 2024 dhe 5 me rekomandimet e bëra në vitin 2023.**

Për shkak të mosveprimit sipas rekomandimeve të bëra, Komisioni parashtrroi kërkesë në gjykatën kompetente për të filluar procedurë kundërvajtjeje për 10 raste të diskriminimit të konstatuar, nga të cilat 3 për raste të konstatuara në vitin 2024 dhe 7 për raste të diskriminimit të konstatuar në vitin 2023, për të cilat afati i veprimit skadoi në vitin 2024.

Nga rastet për të cilat gjykata ka filluar procedurë kundërvajtjeje, në vitin 2024, është dhënë vendim për fajësi për 2 raste të diskriminimit të konstatuar, sepse personat nuk kanë vepruar sipas rekomandimit të bërë nga KPMD-ja.

Në vitin e ardhshëm, Komisioni do të vazhdojë të marrë pjesë në seancat gjyqësore për rastet për të cilat gjykata, me kërkesë të KPMD-së, fillon procedurat kundërvajtëse dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve dhe mendimeve të mbetura, afati i veprimit të të cilave skadon në vitin 2025.

### Përfshirja e KPMD-së në proces gjyqësor si ndërhyrës dhe si mik i gjykatës “amicus curiae”

Sipas Ligjit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, Komisioni ka kompetencë për të filluar dhe ndërhyrë në procedurat gjyqësore për mbrojtje nga diskriminimi, dhe gjithashtu me kërkesë të palës ose me iniciativën e vet, mund të paraqesë kërkesë në gjykatë për ta lejuar atë të veprojë si mik i gjykatës (amicus curiae). Në vitin 2024, Komisioni vendosi pozitivisht dhe parashtrroi kërkesë deri te gjykata për t'u bashkuar me procedurat gjyqësore si mik i gjykatës (“amicus curiae”) pas dy kërkesave të paraqitura nga palët.

Në lëndën e parë, kishte të bënte me kërkesë për përfshirjen e Komisionit në procedurë gjyqësore pas një padie të parashtruar nga interesi publik (actio popularis) e ngritur në Gjykatën Themelore Civile të Shkupit, kundër Ministrisë së Drejtësisë - Drejtoria e Udhëheqjes së Librave të Amzës, nga ana e paditësit Qendra Europiane e të Drejtave të Romëve (QEDR-ja) dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj - ShMJR-ja Shkup. Padia u ngrit me kërkesë për të përcaktuar se i padituri ka shkelur të drejtën për trajtim të barabartë të personave të regjistruar në evidencën e veçantë të librave amzë të lindjeve, të cilët kanë marrë dokument identifikimi duke mos vepruar, pra duke mos zhvilluar procedurë sipas detyrës zyrtare për regjistrim shtesë në pajtim me Ligjin e Evidentimit të Amzës. Duke vepruar kështu, i pandehuri kreu diskriminim të drejtpërdrejtë, të vazhdueshëm dhe të përsëritur në bazë të përkatësisë në një grup të margjinalizuar, etnisë, cilësisë personale dhe statusit shoqëror kundër të gjithë personave të regjistruar në evidencën e veçantë të librave të amzës së të lindurve që kanë marrë dokument identifikimi, dhe diskriminim të tërthortë, të vazhdueshëm dhe të përsëritur në bazë të etnisë kundër të gjithë romëve të regjistruar në evidencën e veçantë të librave amzë të lindjeve që kanë marrë një dokument identifikimi. Duke qenë se padia e cituar trajton problem sistematike që përfshin kategori më të gjerë njerëzish, KPMD-ja paraqiti kërkesë për përfshirje në procedurat gjyqësore si mik i gjykatës.

Lënda e dytë kishte të bënte me kërkesë për përfshirjen e Komisionit në procedurën gjyqësore si mik i gjykatës pas një padie të ngritur në Gjykatën Themelore të Manastirit për mbrojtje

nga diskriminimi kundër personit nga Manastiri për kryerjen e diskriminimit dhe ngacmimit të shumëfishtë, të vazhdueshëm dhe të përsëritur ndaj personave LGBTI-së në rrjetet sociale, me kërkesë për të vërtetuar se i pandehuri ka shkelur të drejtën e trajtimit të barabartë të bashkësisë LGBTI, përkatësisht ka kryer formë më të rëndë të diskriminimit, diskriminimit dhe ngacmimit të shumëfishtë, të vazhdueshëm dhe të përsëritur duke publikuar tekste në rrjetin social "Facebook" me përmbajtje diskriminuese dhe ngacmuese. Komisioni më parë zhvilloi procedura në dy raste për të njëjtin person dhe për të njëjtën shkelje dhe gjeti diskriminim - në rastin e parë, ngacmim të vazhdueshëm dhe të përsëritur në bazë të gjinisë, përkatësinë në grup të marginalizuar, orientimin seksual, identitetin gjinor, statusin personal dhe shoqëror të drejtuar ndaj bashkësisë LGBTI+ në fushën e rrjeteve sociale, ndërsa në rastin e dytë, thirrje dhe nxitje për shqetësim në bazë të përkatësisë në grup të marginalizuar, identitetin gjinor dhe orientimin seksual të drejtuar ndaj personave LGBTI+ në fushën e informacionit publik dhe medias - dhe rekomandoi që personi të kërkojë falje publikisht për diskriminimin e kryer, si dhe njëkohësisht të përmbahet nga publikimi i përmbajtjes shqetësuese, diskriminuese dhe përmbajtjeve që bën thirrje ose nxit diskriminim, si dhe të jetë i vetëdijshëm për komentet me përmbajtje shqetësuese si përgjigje të postimeve dhe, nëse ka të tilla, t'i heqë ato. Duke pasur parasysh se padia e parashtruesit për mbrojtje nga diskriminimi trajton diskriminimin e vazhdueshëm, të shumëfishtë dhe të përsëritur si forma më serioze të diskriminimit, dhe duke marrë parasysh se personi nuk veproi sipas rekomandimeve në mendimet e dy procedurave të zhvilluara më parë para Komisionit, KPMD ka paraqitur kërkesë për përfshirjen në procedurat gjyqësore si mik i gjykatës.

Në lidhje me kërkesat e parashtruara nga palët, Komisioni vendos t'i parashtrorë kërkesë gjykatës për t'u përfshirë me procedurën gjyqësore si ndërhyrës, pra si mik i gjykatës, përderisa kjo është në pajtim me prioritetet strategjike dhe interesat e Komisionit siç parashikohen në dokumentet strategjike, nëse bëhet fjalë për problem sistematik ose diskriminim ndaj grupi më të madh personash, atëherë diskriminim në formë më serioze që është kryer përsëri dhe në kundërshtim me rekomandimet e bëra në procedurë të mëparshme para Komisionit, dhe duke marrë parasysh se kjo nuk reflektohet në funksionimin efektiv të institucionit duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve njerëzore. Në vitin 2024, për dy kërkesa të paraqitura nga palët, KPMD vendosi të mos marrë pjesë në procedurat gjyqësore si ndërhyrës, përkatësisht si mik i gjykatës, dhe i informoi kërkuarët në mënyrë të rregullt dhe të arsyeshme për këtë.

Në nëntor të vitit 2023, Gjykata Themelore Civile në Shkup shqyrtoi vendim me të cilin miratoi padinë e paditësit Shoqata e Bashkësisë së Helsinkit për të Drejtat e Njeriut - Shkup kundër Qeverisë së RMV-së, Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, Ministrisë së Punës dhe të Politikës Sociale, Ministrisë së Shëndetësisë, Inspektoratit Shtetëror të Arsimit, Komunës së Manastirit dhe Komunës së Shtipit, duke kryer diskriminim - veçim ndaj fëmijëve romë në procesin arsimor për shkak të mosndërmarrjes së aktiviteteve përkatëse për rregullimin e mënyrës së rajonalizimit me qëllim shmangien e veçimit të mundshëm, pastaj për të kontrolluar vendimet për rajonalizim të marra nga komunat, mënyrën e zbatimit të këtyre vendimeve në praktikë dhe mënyrën e regjistrimit të fëmijëve romë në shkolla. Në këtë procedurë gjyqësore pas një padie për interes publik (actio popularis), e cila filloi në vitin 2022, KPMD veproi si mik i gjykatës. Në vitin 2024,

KPMD mori njoftimin se kundër vendimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore Civile në Shkup ishte paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit të Shkupit.

## Aktivite parandaluese dhe të tjera të KPMD-së

### Zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare në vitin 2024

Në mars të vitit 2024, në prag të zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare që u mbajtën në prill dhe maj të këtij viti, Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi, në konferencë shtypi, bëri thirrje publike dhe më pas iu drejtua me shkrim institucionale kompetente, që të përmbushen rekomandimet për largimin e diskriminimit ndaj grupeve të ndryshme të qytetarëve në procesin e realizimit të së drejtës së votës, edhe atë:

- Rekomandimet nga mendimi i KPMD-së miratuar në gusht të vitit 2021, në të cilin u vërtetua diskriminim e drejtpërdrejtë të kryer nga ana e Komisionit Shtetëror Zgjedhor dhe diskriminim indirekt që buron nga dispozitat e Kodit Zgjedhor, në bazë të moshës, në realizimin e së drejtës së votës nga personat që kishin mbushur 18 vjet midis dy raundeve të zgjedhjeve presidenciale në vitin 2019. Këta persona, për shkak dispozitave të Kodit Zgjedhor, nuk mund të regjistroheshin në listën zgjedhore midis dy raundeve të votimit, dhe kështu ishin penguar të realizonin të drejtën kushtetuese për të votuar.
- Rekomandimet nga mendimi i KPMD-së miratuar në shtator të vitit 2021, me të cilin u konstatua diskriminim indirekt dhe i shumëfishtë mbi bazë të statusit personal, moshës, gjendjes shëndetësore në fushën e realizimit të së drejtës së votës ndaj qytetarëve që gjatë zgjedhjeve janë të vendosur në institucione shëndetësore. Në këto dy raste, Komisioni rekomandoi ndryshime dhe plotësime të Kodit Zgjedhor me qëllim mundësimin e realizimit të së drejtës kushtetuese për të votuar për këto kategori qytetarësh.
- Më tej, rekomandimi i përgjithshëm i KPMD-së nga 3 dhjetori 2021, me të cilin i rekomandoi Komisionit Shtetëror Zgjedhor që të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme në drejtim të sigurimit të qasjes dhe përshtatjes së duhur të vendvotimeve, me qëllim të mundësimin të qasjes së barabartë për personat me aftësi të kufizuara deri te dhe brenda vendvotimeve në të gjithë vendin. Këto masa dhe veprime duhet të sigurojnë që procedurat e votimit, objektet dhe materialet të jenë të përshtatshme, të qasshme dhe të kuptueshme për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim realizimin e të drejtës për pjesëmarrje në jetën publike dhe politike në baza të barabarta me të tjerët.

Edhe pse gjatë periudhës së kaluar Kodi Zgjedhor pësoi ndryshime përmes procedurës së përshtatjes dhe ekzistonte mundësia për plotësimin e rekomandimeve, Komisioni konstatoi se, menjëherë para mbajtjes së edhe një cikli tjetër zgjedhor, si organ nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, nuk ka marrë zyrarisht informatë nga institucionet kompetente nëse janë bërë ndryshimet në pajtim me rekomandimet e përmendura.

Gjithashtu, KPMD-ja apeloj që Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale të dorëzojë me kohë dhe në mënyrë të përditësuar të dhëna në Komisionin Shtetëror Zgjedhor për të gjithë personat që janë të vendosur në institucionet publike dhe private për mbrojtje sociale të personave të moshuar dhe të pafuqishëm, si dhe të personave me aftësi të kufizuara, me qëllim realizimin e së drejtës së tyre për të votuar. Njëkohësisht, KPMD-ja rikujtoi se me procesin e deinstitutionalizimit, rreth 300 persona jetojnë në formë të re të mbrojtjes, përkatësisht në njësi banimi, por që përmes vendimit për vendosje, ende figurojnë si të vendosur në institucionet për mbrojtje sociale të personave me aftësi të kufizuara (në adresat e Institutit Special Demir Kapi, Institutit për Mbrojtje dhe Rehabilitim të Fëmijëve dhe të Rinjve – Shkup, Institutit për Mbrojtje dhe Rehabilitim “Banja Bansko” – Strumicë). Me qëllim të realizimit të pakufizuar të së drejtës së votës për këto persona, në baza të barabarta me të tjerët, KPMD-ja bëri apel ndaj KSHZ-së që të sigurojë vendvotime alternative në vendbanimet aktuale të këtyre personave, si dhe të respektohen dispozitat e nenit 29 të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Si aktivitet plotësues, Komisioni përgatiti formular të përshtatur për raportim të thjeshtë për fjalim shqetësues në rrjetet sociale dhe në media, i cili ishte i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të KPMD-së. Gjithashtu, KPMD-ja në bashkëpunim me QMBN përgatiti video mesazhe për ngritjen e vetëdijes për proces zgjedhor të drejtë dhe pa diskriminim të gjuhës të urrejtjes, ndërsa gjatë periudhës parazgjedhore realizoi ndjekje të gjuhës së urrejtjes në media, ku u regjistruan më shumë se 50 raste të deklaratave diskriminuese dhe fyese nga përfaqësues politikë. Nga aspekti i aktiviteteve parandaluese, u krye ndjekja e qasjes në vendvotime, i cili, nga analiza e zbatimit të rekomandimeve për qasje në vendvotime, tregoi se 40% e vendvotimeve ende nuk janë të qasshme.

### Aktivitete parandaluese me Agjencinë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar – GIZ Maqedonia e Veriut

Me mbështetjen e KPMD-së dhe Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Shkup (GIZ), Qendra për Art dhe Kulturë Bashkëkohore – ATO nga Manastiri përgatiti **shfaqjen “8%”**?. Shfaqja është realizuar mbi bazën e hulumtimit dhe intervistimit të personave nga qytete të ndryshme të vendit, të cilët kanë qenë të ekspozuar ndaj diskriminimit, dhunës në familje dhe padrejtësive sistematike, dhe vë në pah sfidat me të cilat përballen personat që përjetojnë diskriminim shumëplanësh në jetën e tyre të përditshme. Përveç aktorëve, në shfaqje paraqiten edhe persona të vërtetë, të cilët para publikut ndajnë përvojat e tyre të pakëndshme personale. Shfaqja “8%?” kishte dy interpretime në Shkup (në Teatrin për Fëmijë dhe të Rinj dhe në Teatrin Shqiptar), si dhe u interpretua në qytetet e Shtipit, Manastirit, Kavadarit dhe Demir Hisarit, duke përhapur mesazhin e saj që: “Sistemi jemi ne dhe ne e ndërtojmë sistemin. Të gjithë jemi përgjegjës!”.

## Aktivitete parandaluese me Misionin e OSBE-së Shkup

Si pjesë e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet KPMD-së dhe Misionit të OSBE-së në Shkup gjatë vitit 2024, Misioni realizoi Rishikim Gjnor Participues të Komisionit në tërësi (MBZh). Qëllimi i MBZh-së ishte të vlerësohet shkalla në të cilin aspektet gjinore janë të përfshira në punën e përditshme të KPMD-së – nga aspekti i politikave, projekteve, programeve, buxhetit, struktura dhe kultura organizative, praktikat dhe procedurat e brendshme, dhe promovimi i të mësuarit organizativ në sektor dhe njësi individuale dhe në nivel organizativ të Komisionit. Aktivitetet në KPMD u realizuan në faza, sipas metodologjisë pjesëmarrëse për vetëvlerësim, e zhvilluar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, me mbështetjen e dy eksperteve nacionale të certifikuar për zbatimin e MZHP-së, të cilat i siguroi OSBE-ja. Rishikimi rezultoi me Raport, i cili përmban rekomandime për përmirësime të brendshme dhe të jashtme të KPMD-së në raport të përfshirjes së aspekteve gjinore në politikat kryesore dhe shumëllojshmëritë.

## Aktivitete parandaluese me ADI – Gostivar dhe HOPS Shkup

Në kuadër të projektit “Barazia përmes prizmit të statistikës”, i zbatuar nga Asociacioni për Iniciativa Demokratike (ADI) nga Gostivari dhe HOPS – Zgjedhje për jetë të shëndetshme Shkupi, me mbështetje financiare nga Bashkimi Europian, u përpunua **Metodologjia për mbledhjen e të dhënave për matjen e diskriminimit në vend**, si dhe llojet e të dhënave dhe burimi i të dhënave për matjen e diskriminimit që dallohen nga statistikat zyrtare, të dhënat administrative, anketat, testimet të situatës etj. Brenda projektit, u realizuan disa punëtori me palët e prekura lidhur me përcaktimin e kategorive **më relevante të të dhënave (indikatore për matjen e diskriminimit) për secilën nga fushat**, të cilat duhet të përfshihen në formularin për dorëzimin e të dhënave të ndara për diskriminim. Të gjitha institucionet, në pajtim me Ligjit e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, janë të obliguar t’i mbledhin dhe t’i dorëzojnë këto të dhëna deri te KPMD.

## Aktivitete parandaluese me Institutin për të Drejtat Themelore të Njeriut “Ludvig Bolcman”, Austri

Komisioni, me mbështetjen e projektit “Mbështetje nga BE për Sundimin e Ligjit”, i financuar nga Bashkimi Europian dhe i zbatuar nga Ludvig Boltzman Gesellschaft – Instituti për të Drejtat Themelore të Njeriut, e organizoi botimin e parë të “Bisedave për Barazi”. Përmes kësaj ngjarjeje vjetore, KPMD-ja synon të krijojë hapësirë të hapur për dialog të gjerë mbi çështje më të mëdha, sistematike ose strukturore, që ky institucion i ka identifikuar si sfida kryesore lidhur me barazinë dhe mosdiskriminimin në vend.

**Fokusi i publikimit të parë të “Bisedave për Barazi” ishte arsimiti gjithëpërfshirës dhe atë e hapën Igor Jadrovski, kryetar i Komisionit të Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi, Vesna Janevska, ministre e Arsimit dhe e Shkencës, dhe Barbara Ligëll, udhëheqëse e komponentit 4 të projektit “Mbështetje nga BE për Sundimin e Ligjit”.**

Në ngjarje u mbajtën panele dhe diskutime me përfaqësues dhe përfaqësuese nga institucione vendore, organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare, profesorë universitarë si dhe punonjës dhe punonjëse të arsimit, duke shqyrtuar sfidat për përfshirje, veçanërisht në raport me personat me aftësi të kufizuara, bashkësisë rome, bashkësisë LGBTI dhe edukimin e ndjeshëm ndaj gjinisë. KPMD-ja edhe njëherë theksoi se arsimit është një nga fushat e saj kryesore strategjike dhe bëri thirrje për investime në arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor, me qëllim parandalimin e krijimit të stereotipeve dhe paragjykimeve që nga mosha më e vogël dhe ndërtimin e një shoqërie më të barabartë dhe më të drejtë, të çliruar nga diskriminimi.

Raporti i plotë i ngjarjes është publikuar në faqen zyrtare të internetit të KPMD-së: [Biseda për barazi: Arsimit gjithëpërfshirës](#)

### Aktivitete parandaluese me nismë individuale

Në gusht të vitit 2024, KPMD-ja, pas marrjes së informacioneve nga organizatat qytetare, dorëzoi njoftim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi i mësuesve në shkollat fillore dhe të mesme, të cilat janë punonjëse shtatzëna ose që shfrytëzojnë leje nga puna për shkak të shtatzënisë, lindjes apo prindërimit, dhe që janë të punësuara me kontrata pune me afat të caktuar. Informacionet kishin të bënin me faktin se kjo kategori e të punësuarve, të punësuar nëpër shkolla, janë të rrezikuara që kontratat e tyre të përfundojnë me mbarimin e vitit shkollor më 31.8.2024, dhe për këtë, është e pasigurt e ardhmja e marrëdhënieve të tyre të punës. Komisioni e dorëzoi këtë njoftim me qëllim që MASH-i, brenda kompetencave të saj ligjore, të veprojë në mënyrë të adekuate dhe që kjo kategori e të punësuarve të marrin mbrojtjen e duhur, përkatësisht që të parandalohet përfundimi i marrëdhënieve të tyre të punës për shkak të rrethanave që lidhen me shtatzëninë apo prindërimin.

### Memorandume bashkëpunimi me institucione dhe organizata

Në vitin 2024, KPMD-ja vazhdoi të zhvillojë bashkëpunimin me institucionet shtetërore dhe organizatat e sektorit civil, dhe në këtë drejtim u nënshkruan katër memorandume të reja bashkëpunimi, edhe atë:

- Në janar të vitit 2024, KPMD-ja nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Institutin për të Drejtat Themelore të Njeriut "Ludvig Bolcman", Austri, për zbatimin e projektit "Mbështetja e BE-së për Sundimin e së Drejtës" (2023-2026);
- Në janar të vitit 2024, Komisioni nënshkroi Memorandum Bashkëpunimi me Shoqatën Civile "Shoqata për Iniciativë Demokratike" nga Gostivari në kuadër të projektit "Barazia përmes prizmit të statistikave" të zbatuar nga ana e Shoqatës për Iniciativën Demokratike (ADI) nga Gostivari dhe HOPS - Mundësi për jetë të shëndetshme Shkup, ndërsa financiarisht është mbështetur nga Bashkimi Europian në kuadër të programit të granteve "Mbështetja për Shoqërinë Civile", Instrumenti Europian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut (EIDHR) 2021;
- Në mars të vitit 2024, KPMD-ja dhe Shoqata e Qytetarëve "Qendra e Burimeve për Prindërit e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta" nga Shkupi nënshkruan Memorandum

Bashkëpunimi për të promovuar të drejtat e fëmijëve/personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, për të promovuar, mbrojtur dhe parandaluar barazinë dhe për të mundësuar ndryshime sistemike për përfshirjen e tyre në të gjitha proceset social-shoqërore në pajtim me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi. Ndër të tjera, me këtë Memorandum ra dakord të nisë nisma të përbashkëta për të përmirësuar kuadrin ligjor që garanton barazinë dhe ndalon diskriminimin ndaj personave me aftësi të kufizuara, të ofrojë programe për të rritur ndërgjegjësimin publik për të eliminuar dhe kapërcyer stereotipet ekzistuese ndaj këtyre personave, si dhe të shkëmbejë informacion në lidhje me përparimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara;

Në gusht të vitit 2024, Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi dhe Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nënshkruan Memorandum Bashkëpunimi, me qëllim, ndërmarrjen e aktiviteteve të koordinuara që synojnë promovimin e parimit të barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi dhe sigurimin e gëzimit të plotë dhe të barabartë të të gjitha të drejtave të njeriut dhe lirive themelore për të gjithë qytetarët e vendit. Sipas Memorandumit, të dy institucionet ranë dakord të bashkëpunojnë në aspektin e aktiviteteve dhe fushatave promovuese për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, duke siguruar trajnime dhe udhëzime nga Komisioni për të punësuarit e Kabinetit të kryetares për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar kapacitete për mosdiskriminim dhe barazi, duke u mbështetur nga kryetarja në organizimin e debateve publike dhe tryezave të rrumbullakëta për miratimin ose ndryshimin e ligjeve dhe politikave që synojnë promovimin e barazisë, si dhe duke përdorur zyrat popullore të kryetares për të organizuar aktivitete dhe ngjarje të Komisionit.

Krahas memorandumeve të lidhura, KPMD parashtroi kërkesë për realizimin e takimit dhe konkretizimin e bashkëpunimit dhe me:

- Ministrinë e Vetëqeverisjes Lokale, për shkak nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim dhe fillimin dhe zgjidhjen e problemit të urbanizimit në të gjitha vendet ku jetojnë popullsia rome;
- Ministrinë e Financave, për shkak Buxhetit të KPMD-së, planin për punësim dhe realizim të Marrëveshjes Kolektive, si dhe nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim;
- Kuvendin e RMV-së, për shkak bashkëpunimit rreth plotësimit të rekomandimeve të përgjithshme të miratuara nga KPMD-ja dhe bashkëpunimin për plotësimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me ndryshimet dhe plotësimet ligjore, pastaj miratimin e raporteve vjetore të Komisionit të Buxhetit të Pavarur të KPMD-së si dhe nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim;
- Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve, për shkak nënshkrimit të Memorandumit për bashkëpunim dhe fillim dhe zgjidhje të problemit të urbanizimit në vendbanimet ku jetojnë kryesisht popullatë rome;
- Ministria e Administratës Publike, për fillimin dhe nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe miratimin e planeve vjetore të KPMD-së për punësim;

- Ministrin pa resor, i angazhuar për zbatimin e Strategjisë për përfshirje të romëve 2022-2030, Shaban Saliu.

## Njoftim ndërkombëtar i përfaqësimit

Në vitin 2024, Komisioni i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi (KPMĐ), në bashkëpunim me Qendrën Europiane për të Drejtat e Romëve (QEDR), paraqiti një komunikim me shkrim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, në pajtim me Rregullin 9.2., duke theksuar moszbatimin e aktgjykimit Serija Elmazova dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut. Në këtë paraqitje u theksua veçimi i vazhdueshëm i nxënësve romë në shkolla dhe iu bë thirrje Qeverisë të miratojë masa gjithëpërfshirëse për deveçim, përfshirë zhvillimin e plan veprimit, sisteme për ndjekjen e të dhënave dhe programe arsimore të synuara për mbështetje. Për më tepër, KPMĐ në komunikim theksoi nevojën për ndryshime ligjore, përforcimin e kapaciteteve të autoriteteve lokale dhe përparimin e pjesëmarrjes së palëve të prekura, me qëllim integrimin e plotë të nxënësve romë. Kjo nismë është në pajtim me mandatin më të gjerë të KPMĐ-së për parandalimin e diskriminimit dhe përparimin e qasjes së barabartë në arsim, duke përforcuar përgjegjësinë në zbatimin e aktgjykimit.

## Mendime dhe rekomandime mbi ligjet

Komisioni është organ qendror nacional për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, dhe një nga kompetencat e tij kryesore është të japë mendime për propozime të ligjeve me rëndësi për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, përkatësisht të kontribuojë në ndryshimet dhe plotësimet e kornizës ligjore, me qëllim harmonizimin e saj me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi në mënyrë që ligjet do të përfshijnë dispozita për mbrojtje dhe parandalim nga të gjitha format e diskriminimit.

Në vitin 2024, Komisioni rekomandoi që organet kompetente të fillojnë procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve të caktuara që në formën e tyre ekzistuese, shkaktojnë pabarazi dhe diskriminim ndaj grupeve të ndryshme të qytetarëve. Lëndë e mendimit profesional pas ankesave të paraqitura ishin Ligji i Nënësve Administrativë, Ligji i Kulturës dhe Ligji i Arsimit të Lartë, ndërsa Komisioni paraqiti mendimet e tij mbi Propozimligjin e Arsimit të Mesëm dhe Propozimligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Arsimit Fillor, të cilat i përgatiti Ministria e Arsimit dhe e Shkencës.

Lidhur me **Propozimligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Arsimit Fillor** KPMĐ-ja shprehi pakënaqësi, duke vlerësuar se ndryshimet e propozuara janë të pamjaftueshme për parandalimin e veçimit të fëmijëve romë, siç kërkohet nga vendimi i Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut "Elmazova dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut". Komisioni paralajmëroi se dispozitat ligjore të propozuara lejojnë përsëri përjashtime nga rregulli i regjistrimit në shkollën më të afërt, gjë që e ruan më tej ndarjen. Për më tepër, ndryshimet ndikojnë negativisht në përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi i të rinjve me orientime dhe identitete gjinore të ndryshme. KPMĐ-ja rikujtoi edhe një herë mendimet e miratuara që përcaktojnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar në arsimin fillor, përkatësisht vonesën në sigurimin e asistentëve arsimorë për të gjithë nxënësit të

cilëve u është rekomanduar ndihmë arsimore, si dhe rekomandimin që Ministria të shqyrtojë mundësinë e punësimit të asistentëve arsimorë që kanë treguar rezultate të forta të jenë të punësuar për një periudhë të pacaktuar.

Është gjithashtu shqetësuese që termat “barazi gjinore”, “orientim seksual” dhe “identitet gjinor” po fshihen si baza diskriminuese, gjë që është në kundërshtim me Ligjin e Parandalimit dhe të Mbrojtjes nga Diskriminimi. Gjithashtu, me ndryshimet e propozuara, prindërit marrin përgjegjësi të plotë për përcaktimin e interesave më të mira të fëmijës, pa pjesëmarrjen e profesionistëve, gjë që është në kundërshtim me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Komisioni theksoi se arsimit është fushë kryesore që kërkon reforma themelore ligjore dhe politike, si dhe investime të konsiderueshme për të siguruar arsim gjithëpërfshirës. Mendimi i plotë i KPMD-së mbi Propozim-ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Arsimit Fillor të prillit 2024, dhe në lidhje me zbatimin e vendimit Elmazova dhe të tjerë kundër Maqedonisë së Veriut, është publikuar në faqen e internetit: <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2024/04/mislenje-KSZD-ZOO-Elmazova.pdf>

Vërejtjet e Komisionit në lidhje me Propozimligjin e Arsimit të Mesëm ishin në drejtim të përforcimit të mbrojtjes nga diskriminimi dhe promovimi i barazisë në arsimin e mesëm dhe gjithashtu bëri apel që të plotësohet se një nga qëllimet e arsimit të mesëm është edhe “edukimi për pranimin e dallimeve, përmirësimi i mirëkuptimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, barazisë gjinore dhe multikulturalizmit”. KPMD-ja dha propozime konkrete për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara dhe theksoi se, në lidhje me mbështetjen për ta, duhet të parashikohet sigurimi i transportit falas dhe të përshtatur për nxënësin dhe shoqëruesin e tij, si dhe krijimi i qendrës për mbështetje në mësim brenda shkollës. Gjithashtu, u propozua rregullimi shtesë i pjesës për parandalimin e dhunës ndaj nxënësve, duke përfshirë edhe seksionin për diskriminim, në mënyrë që të zbatohet detyrimi për të raportuar edhe rastet e diskriminimit tek organet kompetente të përcaktuara me ligj, pastaj, drejtori i shkollës duhet të ketë për detyrë të raportojë çdo formë të diskriminimit në shkollë, ndërsa në orët e bashkësisë së paraleles të trajtohen edhe tema për promovimin e barazisë dhe parandalimin e diskriminimit. Në pajtim me rekomandimet e dhëna në mendimet e mëparshme lidhur me raste konkrete të diskriminimit, Komisioni rekomandoi që në Ligjin të hiqen kushtet për kufizimin e të drejtës për transport falas për nxënësit, si dhe kjo e drejtë të vlejë njësoj për nxënësit e regjistruar në shkollat e mesme publike dhe private. Komisioni bëri apel që me Ligjin të përcaktohen mjete minimale vjetore financiare si mbështetje për shkollat e mesme shtetërore, të cilat duhet të transformohen në qendra burimore, si dhe mjete të dedikuara për komunat dhe shkollat e mesme si mbështetje për hapjen e qendrave për mbështetje në të nxënë dhe për sigurimin e materialeve dhe mjeteve të përshtatshme për mësim për nxënësit me aftësi të kufizuara që do të regjistrohen në shkollat e mesme. Mendimi i plotë i KPMD-së për Propozimligjin e Arsimit të Mesëm nga shkurti i vitit 2024 është publikuar në faqen zyrtare të internetit: <https://kszd.mk/wp-content/uploads/2024/05/Мислење.pdf>

KPMD-ja në dhjetor të vitit 2024 bëri apel drejtuar Kuvendit për debat publik dhe realizimin e procesit transparent lidhur me miratimin e paketës së ligjeve në fushën e arsimit, siç janë:

Propozim-Ligji i Arsimit të Mesëm, Propozimligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit të Arsimit Fillor, Propozimligji i Teksteve Shkollore dhe të tjera.

Në lidhje me **Ligjin e Nëpunësve Administrativë**, Komisioni, duke vepruar pas ankesave të dorëzuara nga qytetare që janë të punësuar si nëpunës administrativë në shkolla fillore në Kavadar, ka vërtetuar se neni 65, paragrafi 4 i Ligjit shkakton diskriminim të tërthortë, si ndaj parashtruesve, ashtu edhe ndaj të gjithë nëpunësve administrativë që punojnë në institucione të sektorit publik me më pak se 20 nëpunës administrativë. Diskriminimi buron nga kufizimi i përcaktuar në nenin 65, paragrafi 4, i cili parashikon që në institucion të sektorit publik më së shumti 5% e të punësuarve mund të marrin vlerësimin "A". Pavarësisht se duket si dispozitë e paanshme, për shkak të kufirit të lartë prej 5%, i cili është matematikisht i papërcaktueshëm për institucionet me më pak se 20 nëpunës administrativë, ajo e pengon realizimin e të drejtës të kompensimit për sukses, të paraparë në nenin 94-a për nëpunësit administrativë. Kjo çon në pabarazi midis nëpunësve administrativë në sektorin publik, në varësi të madhësisë së institucionit ku punojnë, dhe përbën diskriminim mbi bazën e vetive personale dhe statusit të të punësuarve. Komisioni rekomandoi që Ministria e Administratës Publike si përgatitës i autorizuar, Qeveria e RMV-së si propozuesi i autorizuar dhe Kuvendi i RMV-së si bartës i organit legjislativ, të bashkëpunojnë dhe të ndërmarrin aktivitete për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit, me qëllim eliminimin e diskriminimit dhe sigurimin e barazisë për nëpunësit administrativë në vlerësim dhe në realizimin e të drejtës për shpërblim për sukses në punë.

